

Enti Rregullator i Ujit



RAPORTI VJETOR

2017

Tiranë,
janar 2018

Publikuar nga:

Enti Rregullator i Ujit (ERRU)
Rr: "Viktor Eftimiu",
Ndërtesa 1, Kati IV
Njësia Administrative Nr. 5, 1022,
Tiranë, Shqipëri

E-mail: public@erru.al
Tel. : +355 4 2258046
[http: www.erru.al](http://www.erru.al)

© Enti Rregullator i Ujit (ERRU)
Janar 2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

RAPORTI VJETOR 2017

**VEPRIMTARIA E ENTIT RREGULLATOR
TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
DHE
GJENDJA NË SEKTORIN UJËSJELLËS KANALIZIME**

JANAR, 2018

PËRMBAJTJA

Shkurtime	2
Përmbledhje	3
1. Veprimtaria vjetore e Entit Rregullator të Ujit	9
1.1. Statusi ligjor dhe përgjegjësitë	9
1.2. Forma organizative e ERRU-së	10
1.3. Veprimtaria rregullatore dhe monitoruese	11
1.3.1. Licencimi i operatorëve ujësjellës kanalizime	11
1.3.2. Tarifat dhe procesi tarifar	13
1.3.2.1. Përballueshmëria	20
1.4. Monitorimi i performancës së sektorit dhe ofruesve të shërbimit	22
1.5. Përmirësimi i standardeve në sektorin UK nëpërmjet instrumenteve rregullatore	23
1.6. Bashkëpunimi dhe marrëdhëniet ndërinstitucionale të ERRU-së	24
1.6.1. Bashkëpunimi me institucionet kombëtare	24
1.6.2. Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare	26
1.6.2.1. ERRU anëtare e organizatave europiane dhe ndërkombëtare	26
1.6.2.2. Marrëdhëniet bilaterale të ERRU-së	27
1.7. Transparenca dhe marrëdhëniet e ERRU-së me publikun dhe median	28
1.8. Të ardhurat dhe shpenzimet e ERRU-së	28
1.8.1. Të ardhurat	28
1.8.2. Shpenzimet operative	30
2. Gjendja në sektorin e ujësjellës kanalizime	33
2.1. Gjendja e performancës së sektorit UK për vitin 2017	33
2.2. Situata në zbatim të reformës në sektorin e ujit	36
3. Rekomandime për përmirësimin e performancës së ERRU-së dhe për sektorin e ujit	41
4. Objektivat e punës së ERRU-së dhe sektorit të ujit për vitin 2018	41
Aneksi 1. Rekomandimet që Kuvendi ka miratuar në rezolutën e tij për ERRU-në për vitin 2017	44
Aneksi 2. Aplikimet e shoqërive dhe situata e licencimit për vitin 2017	46
Aneksi 3. Aplikimet për ndryshimin e tarifave në vitin 2017	48
Aneksi 4. Shoqëri që kanë aplikuar në vitin 2016 dhe janë miratuar në 2017-ën	49
Aneksi 5. Vlera e faturës mujore (me TVSH) për klientët familjarë - viti 2017	50
Aneksi 6. Situata e disa treguesve të performancës për shoqëritë UK	51
Aneksi 7. Situata e tarifave aktuale, viti 2017, për shërbimet UK	52

Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura
UK	Ujësjiellës kanalizime
U	Ujësjiellës
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
KM	Këshilli i Ministrave
SHA	Shoqëri aksionere
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
NJMB	Njësia e Monitorimit dhe Benchmark
SHUKALB	Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë
NJQV	Njësitë e qeverisjes vendore
TKP	Treguesit kryesorë të performancës
ITUN	Impiant i trajtimit të ujërave të ndotura
OM	Kosto operative dhe mirëmbajtjeje

Përmbledhje

Raporti vjetor 2017 i aktivitetit të ERRU-së, instrument informimi dhe transparence

Raporti vjetor 2017 i aktivitetit të ERRU-së paraqet veprimtarinë e këtij institucioni në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar.

Qëllimi i raportit është informimi dhe transparencja ndaj Kuvendit të Shqipërisë, institucioneve dhe aktorëve të tjerë që lidhen me sektorin e ujit për aktivitetin e ERRU-së në përmbushje të misionit të tij që të *"sigurojë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që operatorët e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve t'i ofrojnë ato me cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe të jenë financiarisht të qëndrueshme"*.

Në raport përcaktohen edhe objektivat e punës së ERRU-së në të ardhmen, përfshirë dhe përmirësimet ligjore në drejtim të forcimit të rolit të tij si institucion i pavarur. Nga ana tjetër, në raport pasqyrohet dhe analizohet gjendja e performanca e sektorit të ujit, reforma, si edhe jepen rekomandime për rritjen e performancës së tij në të ardhmen.

ERRU, statusi ligjor dhe përgjegjësitë

ERRU është një institucion i pavarur, i krijuar me ligj, përgjegjës për:

- vendosjen e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime për shoqëritë UK;
- licencimin e shoqërive UK;
- mbrojtjen e interesave të konsumatorëve për garantimin e shërbimeve cilësore nga shoqëritë UK, si ndaj abuzimeve për shërbimet monopol të ujësjellës kanalizimeve të ujërave të ndotura.

Licencimi i shoqërive UK

Gjatë vitit 2017 kanë aplikuar për licencë apo rinovim të saj në total 43 shoqëri UK, nga të cilat KKRR ka licencuar 31 shoqëri, ndërsa 12 aplikime janë akoma në proces. Referuar kategorive të shërbimit, 57 shoqëri kanë kategorinë e *"grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik"*. Nga këto shoqëri vetëm 2 prej tyre disponojnë edhe kategorinë e *"përpunimit të ujit të pijshëm për konsum publik"*, 40 prej tyre edhe atë të *"grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura"*, dhe vetëm 4 shoqëri UK disponojnë kategorinë e *"përpunimit të ujërave të ndotura"*.

Shoqëritë hasin vështirësi për licencim sipas reformës së sektorit të ujit në përputhje me reformën administrative territoriale, përkatësisht për ndarjen e aksioneve, marrjen e akt-miratimit higjeno-sanitar dhe në gjetjen e drejtuesve teknikë të kualifikuar.

Procesi i miratimit të tarifave për shërbimet UK

Gjatë vitit 2017 ERRU ka miratuar tarifa për shoqëritë UK, përkatësisht: UK Durrës, UK Tiranë, UK Gjirokastrë, UK Berat-Kuçovë, UK Lushnjë, UK Ura Vajgurore, UK Korçë. Veçojmë si raste më të rëndësishme dhe ndjeshmëri në publik, miratimin e tarifave të reja për shoqëritë UK Durrës dhe UK Tiranë që mbulojnë praktikisht 1/2 e popullsisë së vendit. Miratimi

i tarifave të reja për UK Durrës ka pasur si bazë modelin financiar hartuar për financimin prej 85 milionë US\$ nga Banka Botërore, në mënyrë që të mbulohen 100% kostot e O&M. UK Tiranë rritjen e tarifave e kërkoi për të mbuluar nevojat për investime për 5 vitet e ardhshme me objektivin madhor për të furnizuar me ujë Tiranën 24 orë/ditë.

Rritja e tarifës do të përballojë 30% të nevojave për investime, ndërkohë që 70% e tyre do të mbulohen nga kreditë që parashikohen të merren nga donatorët. Janë në proces vlerësimi 7 aplikime nga shoqëritë, përkatësisht: UK Maliq, UK Gramsh, UK Krujë, U Malësi e Madhe, UK Skrapar, UK Shkodër, UK Fier.

Përballueshmëria

ERRU përdor si kriter për përballueshmërinë e pagesës së faturës së shërbimeve UK, vlerën prej 5% të të ardhurave mesatare për familje. INSTAT vlerëson se të ardhurat mujore mesatare të përgjithshme të një familjeje janë rreth 70,000 lekë/muaj, që i korrespondon një niveli të përballueshmërisë së tarifave prej rreth 300 lekë/m³. Tarifatat aktuale të shërbimeve UK janë akoma mjaft më të ulëta se kjo vlerë.

ERRU ka në vëmendjen e saj në të ardhmen saktësimin e kriterëve dhe metodologjisë për përballueshmërinë edhe me përvoja të tjera ndërkombëtare, si dhe të dhënave të disponueshme nga INSTAT duke pasur parasysh mbrojtjen e konsumatorëve me të ardhura të ulëta (jo mesatare).

Përmirësimi i standardeve në sektorin e ujit nëpërmjet instrumenteve rregullatore

ERRU gjatë vitit 2017 ka vijuar punën për të përmirësuar instrumentet rregullatore që lidhen me aplikimin për ndryshimin e tarifave. Në këtë kuadër, ERRU ka rishikuar dhe miratuar dokumentet e mëposhtme:

- *"Udhëzuesi për organizimin e seancës dëgjimore me publikun";*
- *"Modeli i formularit të informacionit teknik"* që shoqëritë duhet të depozitojnë në ERRU, si pjesë e database-s në mbështetje të dokumentacionit të aplikimit për tarifa të reja dhe për licencë;
- *"Tabela dhe udhëzime ndihmëse"* për shoqëritë që po riorganizohen për shtesat e zonës së shërbimit, kryesisht për zonat rurale;
- *"Forma e kontratës ERRU-shoqëri UK"* që plotëson dhe saktëson kushtet e objektivave dhe të monitorimit, si dhe të marrëdhënieve e detyrimeve financiare ligjore të shoqërisë ndaj ERRU-së.
- *"Rregullore e Inspektimit të veprimtarisë së Shoqërive UK që veprojnë në sektorin e ujit".*

Të ardhurat dhe shpenzimet e ERRU-së

Burimet e financimit të aktivitetit të veprimtarisë së ERRU janë pagesat rregullatore vjetore dhe pagesat për licencime të vendosura nga vetë rregullatori që duhet të paguajnë shoqëritë UK. Të ardhurat totale të realizuara gjatë vitit 2017 janë në shumën 49,550,514 lekë, që rezulton se gjatë vitit 2017 janë mbledhur plus 3,020,844 lekë nga detyrimet e prapambetura që shoqëritë UK kanë pasur ndaj ERRU. Plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU, për vitin 2017, miratuar me VKM, ishte në shumën 47,323,000 lekë. Realizimi i shpenzimeve të kryera nga ERRU

gjatë vitit 2017 ishte në shumën 34,761 mijë lekë, ose 73% të fondit të planifikuar, të detajuara si më poshtë:

Arsyet e realizimit të shpenzimeve në përqindjen e mësipërme janë nga mosplotësimi i të gjitha funksioneve në organikë, ulja e shpenzimeve në udhëtime brenda vendit, konsumi i karburantit, shpenzime të telefonisë fikse, si edhe prej kursimeve nga prokurimet për rikonstruksionin e zyrave.

Performanca e sektorit të ujësjellës kanalizimeve

Performanca e sektorit të ujësjellës kanalizimeve jepet në mënyrë të përmblendhur në tabelën e mëposhtme, bazuar në *treguesit kryesorë të performancës* që ERRU përdor për të vlerësuar performancën e shoqërive UK. Vlerat e treguesve kryesorë të performancës në tabelën e mëposhtme janë llogaritur në bazë të të dhënave të 9 muorit të vitit 2017 të ekstrapoluara për kohëzgjatjen vjetore të tyre. Raporti pasqyron dhe analizon gjendjen, performancën dhe tendencën e zhvillimit të sektorit UK për vitin 2017, ndërsa analiza e plotë dhe individuale për secilën shoqëri UK do të jepet në "Raportin e performancës për shoqëritë UK për vitin 2017" që përgatit ERRU pasi të disponohen të dhënat e plota e përfundimtare të aktivitetit njëvjeçar të tyre.

Treguesit kryesorë të performancës [1]

Nr	Treguesit	Njësia	2016	2017	Tendenca
1	Mbulimi me ujë	%	79	78.7	=
2	Mbulimi me kanalizime	%	50	50	=
3	Mbulimi i kostove O&M	%	118	113	↘
4	Norma e arkëtimit	%	92	84	↘
5	Niveli i matjes	%	64	68	↗
6	Ujë pa të ardhura	%	67	65	↗
7	Efiçenca e stafit (staf/1000 lidhje uji)	nr.	8.3	9.2	↘
8	Kohëzgjatja e furnizimit me ujë	orë/ditë	11.4	11.4	=

Shënim: Burimi i informacionit AKUK

Vlerat e treguesve kryesorë të performancës kanë ndryshime mjaft të vogla në krahasim me vitin paraardhës, gjë që tregon që sektori vazhdon të *performojë në gjendje stanjacioni me një tendencë të lehtë përkeqësimi*.

Një nga arsyet kryesore të kësaj tendence në rënie të performancës është se viti 2017 ka qenë një vit elektorale, që zakonisht shoqërohet me shtim artificial të numrit të punonjësve në shoqëritë UK, rritjen e shpenzimeve në përgjithësi, si dhe të një rënie të vullnetit të zbatimit të ligjit që

^[1] TPK për vitin 2017 janë përllogaritur në bazë të të dhënave 9 mujore të marra nga Njësia e Monitorimit dhe Benchmarking pranë AKUK

reflektohet në uljen e normës së arkëtimit. Nga ana tjetër, situata aktuale në sektor nuk na lejon të bëjmë një gjykim të saktë të performancës së sektorit, pasi shoqëritë UK janë duke kryer procedurat e riorganizimit, gjë e cila ndikon në saktësinë e të dhënave e të treguesve. Njëkohësisht, në shoqëritë që kanë përfunduar riorganizimin, treguesit e tyre të performancës nuk kanë bazë krahasimi për të kaluarën për zonën e re të shërbimit që ato mbulojnë.

Analizë e çdo treguesi të performancës

"Mbulimi me ujë" dhe **"Mbulimi me kanalizime"** kanë një përkeqësim të vogël, për shkak të shtimit në zonën e shërbimit të popullsisë së zonave rurale, të cilat e kanë këtë tregues më të vogël se ajo e zonave urbane.

"Mbulimi i kostos së O&M" është përkeqësuar me 5%, për shkak të rritjes së shpenzimeve, kryesisht nga rritja e numrit të punonjësve, energjisë elektrike, si edhe i zërit të riparim-mirëmbajtjes. Qeveria qendrore në 2017 ka dhënë subvencion prej 11 milionë lekë. Vlerësohet se vetëm 18 nga 57 shoqëri mbulojnë kostot e O&M mbi 100%, të cilat përfaqësojnë 56% të popullsisë së shërbyer.

"Norma e arkëtimit" ka pësuar një rënie me 8%, për shkak të tendencës së moszbatimit të ligjit në periudhën elektorale, si edhe nga shtimi i zonës së shërbimit të shoqërive me pjesën rurale që ka tregues të ulët arkëtimi.

"Uji pa të ardhura", si treguesi më i rëndësishëm i performancës, ka një përmirësim me rreth 2%, por mbetet akoma në vlera të papranueshme. Ky përmirësim mund të jetë rrjedhojë e përmirësimit me rreth 4% të nivelit të matjes individuale të konsumatorëve.

"Niveli i matjes" është përmirësuar me 4%, si rezultat i investimeve në sektor.

"Eficienca e stafit" ka një përkeqësim me 1 person/1000 lidhje më shumë. Në vlerë absolute, numri i punonjësve të punësuar nga vetë shoqëritë është rritur me 519 punonjës, që vjen si rezultat e efektit të vitit elektorale për punësimet artificiale.

"Kohëzgjatja e furnizimit me ujë" si tregues ka mbetur pothuajse i pandryshuar (zvogëluar me 0.9 orë/ditë). Duke pasur parasysh vështirësitë në matjen dhe llogaritjen e tij, është i vështirë interpretimi i ecursisë së këtij treguesi.

Situata në zbatim të reformës në sektorin e ujit

Reforma në sektorin e ujit i ka fillimet e saj me daljen e VKM nr. 63 në janar të vitit 2016, e cila presupozonte që riorganizimi i shoqërive UK sipas parimit 1 shoqëri = 1 bashki duhet të kishte përfunduar në fund të vitit 2016. Riorganizimi i sektorit, në fakt, rezultoi një sfidë mjaft e madhe për shoqëritë dhe bashkitë për t'u realizuar në formën e kërkuar brenda afateve të përcaktuara në VKM.

Procesi i inventarizimit, vlerësimit dhe regjistrimit të asetëve, regjistrimi i tyre në QKB paraqitej mjaft problematik, për shkak të mungesës së dokumentacionit për to, si dhe i dokumentacionit tjetër të nevojshëm për t'u regjistruar në QKB. Përfundimisht, deri në fund të vitit 2017 kanë

përfunduar riorganizimin dhe janë licencuar 24 shoqëri UK nga rreth 60 në total. Pavarësisht reformës së nisur në janar 2016, sektori i ujit nuk shfaqi tendenca përmirësimi dhe karakterizohej akoma nga:

- a) mungesa e përgjegjësisë dhe kontroll-monitorimit nga organet mbikëqyrëse mbi shoqëritë, në veçanti mbi drejtorët e shoqërive;
- b) mungesa e investimeve fizike të mjaftueshme në sektor;
- c) zbatimi i dobët i legjislacionit për klientët me lidhje të jashtëligjshme, debitorëve, megjithëse fatura është titull ekzekutiv.

Për këtë arsye, në muajin tetor 2017 Qeveria rilançoi reformën në sektorin e ujësjellës kanalizimeve, që konsiston në:

- eliminimin e lidhjeve të paligjshme që vlerësohen të jenë në rreth 20% të abonentëve;
- zbatimin e ligjshmërisë për kundërvajtësit dhe abuzuesit;
- pajisjen 100% të konsumatorëve me matës uji;
- rritjen e normës së arkëtimit, përfshirë dhe debitë e trashëguara;
- shpërndarjen e investimeve bazuar në performancë;
- agregimi i sektorit.

Eliminimi i lidhjeve të paligjshme do të ketë një fazë mirëkuptimi dhe vullnetarizmi në deklarimin dhe legalizimin e tyre (deri më 1 shkurt 2018) që do të ndihet më tej nga faza (mbas 1 shkurtit) që do të fillojë zbatimi i ligjit duke i konsideruar praninë e lidhjeve të paligjshme si vepër penale. Reforma parashikon gjithashtu që të subvencionohen shtresat në nevojë, si dhe disa kategori të tjera të veçanta si invalidët e ndryshëm etj., të cilëve do t'u instalohet falas ujëmatësi, si dhe do të furnizohen me ujë falas për një sasi prej 20 litra/ditë/banor.

Objektivat e ERRU-së për vitin 2018

- Rishikimi i "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura", miratuar me vendim të KKRR nr. 42, datë 09.12.2015;
- Marrjen e iniciativës për rishikimin e Kodit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime, aprovuar me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, si model i rregullores "Për furnizimin me ujë dhe kanalizime në zonën e shërbimit të shoqërisë anonime ujësjellës kanalizime";
- Rishikimi i ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar;
- Në bashkëpunim me Inspektoratin Sanitar Shtetëror t'u propozohen ministrive përkatëse të linjës që të bëhen ndryshime në ligjin nr. 7643, datë 02.12.1992, për Inspektoratin Sanitar Shtetëror, i ndryshuar, si dhe rishikim të udhëzimit të ministrit të Shëndetësisë, nr. 510, datë 13.12.2011, "Për inspektimet higjeno-sanitare në funksion të lëshimit të akt-miratimit higjeno-sanitar";

- Hartimi dhe botimi i Raportit të Performancës së Shoqërive Ujësjiellës Kanalizime për vitin 2017 jo më vonë se mesi i korrikut 2018;
- Të luajë një rol nxitës dhe ndërgjegjësues që paralelisht me reformën të fillojë realizimi i një shembulli pilot agregimi i suksesshëm i dy ose më shumë shoqërive UK në sektor;
- Hartimi dhe miratimi i një rregulloreje të trajtimit të ankesave të konsumatorëve brenda vitit 2018, e cila do të përcaktojë qartësisht kushtet dhe procedurat për shqyrtimin dhe zgjidhjen e tyre.

Rekomandime për përmirësimin e performancës së ERRU-së dhe për sektorin e ujit

Të hartohen ndryshimet përkatëse në ligjin nr. 8102, i ndryshuar, me qëllim forcimin e rolit të ERRU-së si institucion i pavarur, përkatësisht:

- *ERRU të jetë pala monitoruese, përcaktuese dhe vlerësuese e treguesve të performancës së kontratave të performancës që do të lidhen në kuadër të reformës për ujin ndërmjet AKUK dhe bashkive;*
- *Saktësimi dhe ndarja e përgjegjësi dhe të drejtave midis ERRU-së dhe AKUK që aktualisht janë konfuze dhe me mbivendosje;*
- *Për të luajtur plotësisht rolin si monitorues i shoqërive UK dhe të sektorit të ujit duke përfshirë në strukturat e tij të Njesisë së Monitorim Benchmark që aktualisht ndodhet pranë AKUK;*
- *Ngritjen institucionalisht të Këshillit Teknik pranë AKUK për vlerësimin tekniko-ekonomik të të gjitha projekteve të propozuara në fushën e ujësjiellës kanalizimeve me përfaqësues edhe nga ERRU;*
- *Propozim për rishikimin e VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" me rekomandime konkrete në funksion të kërkesave të situatës aktuale të reformës së sektorit;*
- *Për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarit të KKRR jo nga Këshilli i Ministrave, por nga Kuvendi i Shqipërisë, si dhe të kohëzgjatjes së mandatit nga 4 në 5-vjeçar, përfshirë dhe kriteret që ato duhet të përmbushin;*
- *Për një përmirësim në menaxhimin e kapaciteteve njerëzore dhe financiare të buxhetit të ERRU-së për rritjen e kapaciteteve dhe efikasitetit të punës së tij.*

1. Veprimtaria vjetore e Entit Rregullator të Ujit

1.1 Statusi ligjor dhe përgjegjësitë

Qëllimi kryesor i ligjit 8102 është mbrojtja e interesave publike dhe sigurimi që në një sektor monopol si ai i furnizimit me ujë e largimit të ujërave të ndotura në Shqipëri, të krijohet një mjedis transparent, ligjor dhe i rregulluar, që shprehet në vizionin e ERRU-së, si më poshtë: “Një sektor ujësjellës kanalizime financiarisht i vetëqëndrueshëm që ofron shërbime të një cilësie të lartë, por të përballueshme, për të gjithë konsumatorët në Shqipëri”. Për realizimin e funksioneve të parashikuara në ligjin nr. 8102, i ndryshuar, Enti Rregullator i Ujit ka miratuar:

- Rregullore e licencimit për procedurat e dhënies dhe rinovim të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, si dhe kushtet e licencës (miratuar me vendim të Komisionit Kombëtar Rregullator të ERRU nr. 50, datë 30.12.2013);
- Miratimi i politikave tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura (vendimi nr. 39, datë 09.12.2015);
- Miratimi i dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura, i detyrueshëm për t’u plotësuar nga të gjithë operatorët që ofrojnë këto shërbime (vendimi nr. 40, datë 09.12.2015);
- Procesin e miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura, e detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjithë operatorët që kryejnë këto shërbime (vendimin nr. 41, datë 09.12.2015);
- Metodologjinë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura, e detyrueshme të zbatohet nga të gjithë operatorët që ofrojnë këto shërbime (vendimi nr. 42, datë 09.12.2015);
- Bilanci i ujit, (vendimin nr. 46, datë 27.12.2013);
- Kontrata e shërbimeve ujësjellës kanalizime mes konsumatorëve dhe shoqërive, (vendimi nr. 8, datë 04.02.2011, i ndryshuar);
- Udhëzuesi i seancës dëgjimore me publikun (vendimi nr. 37, datë 06.09.2017);
- Rregullore e inspektimit të veprimtarisë së shoqërive UK që veprojnë në sektorin e ujit (vendimi nr. 58, datë 29.12.2017).

Ndërkohë gjatë vitit 2017 puna për ndryshimin e ligjit nr. 8102 ka ndaluar. Grupi i punës nuk ka zhvilluar asnjë takim, ndërkohë që rishikimi dhe ndryshimi i tij është tejet i rëndësishëm, u përgjigjet zhvillimeve që ka pësuar sektori ujësjellës kanalizime dhe plotëson vizionin e ERRU-së për të bërë të mundur rritjen e pavarësisë institucionale.

1.2 Forma organizative e ERRU-së

Struktura dhe organika e ERRU-së rregullohen në përputhje me ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”. Si institucion i pavarur, i krijuar me ligj, struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të nëpunësve të Entit, miratohen me vendim të Kuvendit.

Struktura dhe organika e ERRU-së janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr. 34/2016, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)".

Me miratimin e kësaj strukture, për Entin u mundësua realizimi i përmirësimeve dhe ndryshimeve të nevojshme në kuadër të ristrukturimit të sektorit UK, si rrjedhojë e reformës territoriale. Ndryshimi gjithashtu erdhi edhe si përpjekje e ERRU-së për përmirësimin e kapaciteteve të tij dhe pavarësisë operationale. Gjatë vitit 2017, në përputhje me strukturën organizative, kapacitetet njerëzore të Entit janë rritur me 4 nëpunës të rinj.

Në përbërje të Entit Rregullator të Ujit është Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), Drejtoria Tekniko-Ekonomike, Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.

Struktura organizative e ERRU-së, aprovuar nga Kuvendi, jepet në figurën 1.




Figura 1. Struktura e Entit Rregullator të Ujit

Në përbërje të strukturës së ERRU-së janë gjithsej 28 punonjës, 5 anëtarë të komisionit, 20 nëpunës të administratës dhe 3 punonjës mbështetës.

1.3 Veprimtaria rregullatore dhe monitoruese

1.3.1 Licencimi i operatorëve ujësjellës kanalizime

Pas miratimit të reformës administrative-territoriale, Enti Rregullator i Ujit ka vazhduar të kryejë funksionet e tij, duke zbatuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për të gjitha shoqëritë UK në lidhje me licencimin e tyre.

Aktualisht në sektorin ujësjellës kanalizime janë të licencuara nga ERRU 57 shoqëri për kategorinë e shërbimit të *"grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik"*. Nga këto shoqëri vetëm 2 prej tyre disponojnë në licencë edhe kategorinë e *"përpunimit të ujit të pijshëm për konsum publik"*, 40 prej tyre edhe atë të *"grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura"*, dhe së fundmi vetëm 4 shoqëri UK disponojnë në licencë kategorinë e *"përpunimit të ujërave të ndotura"*.

Deri më tani në vendin tonë janë në funksion 8 impiante të përpunimit të ujërave të ndotura, prej të cilave 4 nuk janë të licencuara akoma nga ERRU, për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit përkatës nga ana e shoqërive që i kanë në administrim. Theksohet fakti se procesi i licencimit për shoqëritë UK në vitin 2017 ka qenë i lidhur ngushtë gjithashtu edhe me zbatimin e VKM nr. 63, datë 27.1.2016, që presupozon që të gjitha shoqëritë të përfundojnë inventarizimin e aseteve të të gjitha sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të njësive administrative (ish-komunat) që kanë marrë në juridiksionin e tyre, proces i cili akoma nuk ka përfunduar.

ERRU përgjatë këtyre dy viteve ka nxitur të gjitha shoqëritë që të vazhdojnë me procesin e inventarizimit në zbatim të riorganizimit të sektorit UK, reflektimit të këtyre ndryshimeve në QKB dhe më pas të vijnë në ERRU për licencim dhe miratimin e tarifave në përmbushje dhe të kërkesave të VKM nr. 63, datë 27.1.2016. Kjo gjë është theksuar në mënyrë të veçantë në të gjitha takimet në terren që ERRU ka realizuar me kryetarët e bashkive dhe drejtuesit ekzekutivë të shoqërive UK gjatë vitit 2017.

Gjatë vitit 2017 kanë aplikuar për licencë apo rinovim të saj në total dyzet e tre (43) shoqëri UK. Arsyeja kryesore e kërkesës për licencim ka qenë përfundimi i afatit të licencës, ndryshimi i zonës së shërbimit pas reformës administrative-territoriale, ndryshimet në drejtuesit ligjor dhe/ose teknik, si dhe krijimi i shoqërive të reja, përkatësisht: Sh.a UK Cërrik dhe Sh.a UK Roskovec dhe Sh.a UK Pustec. Si përfundim, gjatë vitit 2017 KKRR ka licencuar tridhjetë e një (31) shoqëri, ndërsa dymbëdhjetë (12) aplikime të tjera mbeten në proces (shih aneksi 2 tabela 1).

Theksohet fakti se në zbatim të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit, pika 2 aneksi 1, në përputhje me VKM nr. 63, vetëm njëzet e katër (24) nga 61 shoqëri (një shoqëri UK - një bashki) kanë arritur të përfundojnë procedurat brenda afateve të përcaktuara.

Arsyet kryesore në vonesat e zbatimit të VKM nr. 63, datë 27.1.2016, nga shoqëritë UK për të arritur deri te procesi i rinovimit të licencës pranë ERRU-së, janë:

- **Vështirësi në ndarjen e aksioneve** në shoqëritë që përfshijnë në zonën e tyre të shërbimit më shumë se një (1) bashki dhe reflektimin e ndryshimeve në QKB;

- **Vështirësi në marrjen e akt-miratimit higjeno-sanitar**, e cila këtë vit ka ardhur kryesisht se shoqëritë kanë zgjeruar zonën e shërbimit;
- **Vonesa në dorëzimin e dokumenteve të nevojshme** nga ana e shoqërive për nisjen e procedurës së licencimit dhe kryesisht këto vonesa kanë ardhur për pajisjen me lejet e mjedisit, dëshmitë e penaltetit, gjë e cila vjen dhe si pasojë e neglizhencës nga ana e shoqërisë;
- **Vështirësi në gjetjen e drejtuesve teknikë** të kualifikuar sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 958;
- Gjithashtu është vënë re dhe **një ndryshim në masë i drejtuesve ligjorë** të shoqërive UK, të cilët nuk përzgjidhen sipas kualifikimeve të kërkuara në statutin tip i miratuar me VKM nr. 63, datë 27.1.2016, ku mund të përmendim si më problematikon që ndërron pothuajse dy herë në vit drejtuesin ligjor, UK Elbasan.

Vështirësitë e mësipërme vazhdojnë të jenë pengesat kryesore për licencimin dhe rinovimin e licencës në kohë të shoqërive UK. Situata e licencimit deri në fund të vitit 2017 për 57 shoqëritë UK është si më poshtë:

- tridhjetë e tetë (38) operatorë disponojnë licenca të vlefshme;
- dymbëdhjetë (12) operatorë janë në proces të rinovimit të licencës;
- tetë (8) operatorë janë pa licencë, nga të cilat Sh.a U Këlcyrë, Sh.a UK Ballsh, Sh.a UK Fushë Arrëz, Sh.a U Has kanë probleme me regjistrimin dhe përditësimin në QKB, vështirësi në gjetjen e një drejtuesi të kualifikuar teknik, ndërsa Sh.a UK Peqin për shkak të problemeve me cilësinë e ujit nuk arrin të pajiset me akt-miratimin higjeno-sanitar. Tre shoqëritë e tjera, si: Sh.a UK Krastë, Sh.a U Novoselë dhe Sh.a U Pukë fshat janë shoqëri që në zbatim të reformës nuk duhet të ekzistojnë.




Figura 2. Situata aktuale e licencimit

Në figurën 2, jepet situata e licencimit në përqindje, ndërsa për secilën nga 57 shoqëritë UK jepet në aneksin 2, tabela 2.

1.3.2 Tarifat dhe procesi tarifar

Në zbatim të ligjit nr. 8102, datë 28.06.1998, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, ERRU është autoriteti që miraton tarifën e shërbimeve UK si dhe përcakton metodologjinë e përlllogaritjes së tarifave.

Procedura për vendosjen e tarifave fillon me propozimin e bërë nga i licencuari, dhënien e mendimit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, raporti mbi opinionet dhe reagimet e konsumatorëve gjatë seancës dëgjimore me publikun që zhvillon shoqëria, dhe përfundon me miratimin përfundimtar të tarifave nga Enti Rregullator i Ujit.

Për të bërë të mundur realizimin e këtij procesi, Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), bazuar në kompetencat që i jep ligji, ka miratuar rregullat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha subjektet e licencuara, si më poshtë:

- Vendimi nr. 39, datë 09.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" ;
- Vendimi nr. 40, datë 09.12.2015, "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura";
- Vendimi nr. 41, datë 09.12.2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura";
- Vendimi nr. 42, datë 09.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura";

Objektivi kryesor i ERRU-së në procesin e miratimit të tarifave është gjetja e balancës ndërmjet mbrojtjes së interesit të konsumatorëve dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimit.

Referuar ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" bashkitë e reja janë përgjegjëse për shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura dhe në të gjithë zonën administrative. Sipas vendimit të KM nr. 63, dt. 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, operatorët duhet të riorganizohen duke përfshirë në zonën e tyre të shërbimit të gjithë territorin administrativ të bashkisë, për të cilën duhet të pajisen me licencë pranë ERRU-së, si dhe brenda tre muajve mbas marrjes së licencës të aplikojnë për tarifa të reja për këto shërbime.

Në përgjithësi shoqëritë e riorganizuara aplikojnë për tarifa pranë ERRU-së, por këto janë tarifa të diferencuara për ish-zonën e shërbimit nga zonat e reja që ato kanë marrë në ngarkim kryesisht nga zonat rurale. Procedura e aplikimit, e analizës nga ana e ERRU-së deri në vendimmarrje nga KKRR është më e thjeshtësuar, pasi analiza sipas rastit është përqendruar tek analiza e kostove dhe të ardhurave duke u nisur nga situata dhe tarifën aktuale që shoqëritë aplikojnë (tarifa të miratuara nga ish-njësitë e qeverisjes vendore).

Për rastet e shoqërive ekzistuese që nuk kanë ndryshuar dhe kanë aplikuar për ndryshim tarifash, vlerësimi i propozimit për ndryshimin e tarifave për secilin aplikim është bërë mbi bazën e analizës së situatës aktuale ekonomike, financiare dhe treguesve kryesorë të performancës, tendencës së tyre, objektivave të shoqërisë për tarifat e kërkuara si dhe kushteve specifike të operimit, të cilat bëjnë që edhe pritshmëritë nga ndryshimi i tarifave të jenë të ndryshme për çdo shoqëri. Gjatë vitit 2017 kanë përfunduar procedurën dhe janë marrë vendimet për miratimin e tarifave të reja për shoqëritë në tabelën 1.

Tabela 1. Shoqëritë për të cilat KKRR ka marrë vendimet në lidhje me ndryshimin e tarifave.

Nr.	Operatori	Numri i vendimit	Data
1	Sha UK Gjirokastrë	12	30.03.2017
2	Sha UK Berat-Kuçovë	13	30.03.2017
3	Sha UK Lushnjë	17	05.05.2017
4	Sha UK Durrës	31	18.07.2017
5	Sha UK Tiranë	47	07.11.2017
6	Sha UK Ura Vajgurore	48	07.11.2017
7	Sha UK Korçë	56	29.12.2017
8	Sha UK Berat-Kuçovë	57	29.12.2017

Edhe në zbatim të rekomandimeve që Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar në rezolutën e tij pika 1, ERRU është angazhuar maksimalisht për përballimin në kohë dhe me cilësi të të gjithë aplikimeve duke u treguar të kujdesshëm si në analizat e bëra nga sektorët përkatës, por dhe në vendimmarrjet e KKRR, me qëllim që konsumatorët të paguajnë kosto të justifikuara dhe të përballeshme për një shërbim cilësor, shoqëruar kjo me një menaxhim sa më efikas dhe me përgjegjësi maksimale nga ana e ofruesve të shërbimit.

Shoqëritë vazhdojnë të paraqesin aplikimet për ndryshimin e tarifave me mangësi në dokumentacion dhe me pasaktësira në të dhënat. Kjo bën që dhe analizat si dhe vendimmarrjet për këto shoqëri të zgjaten në afatet kohore, derisa të plotësohet dokumentacioni në përputhje me standardet e përcaktuara në metodologjinë e vendosjes së tarifave.

Nga aplikimet e vitit 2017 shoqëritë e paraqitura në tabelën 2 të mëposhtme janë ende në proces:

Tabela 2. Shoqëritë të cilat janë ende në proces për ndryshimin e tarifave

Nr	Operatori	Faza e aplikimit	Shënime
1	Sha UK Maliq	Dokumentacion i plotësuar	Në proces
2	Sha UK Gramsh	Dokumentacion i plotësuar	Në proces
3	Sha UK Krujë	Dokumentacion i paplotësuar	Pasaktësi të dhënash
4	Sha U Malësi e Madhe	Dokumentacion i plotësuar	Në proces
5	Sha UK Skrapar	Dokumentacion i paplotësuar	Nuk ka zhvilluar seancën dëgjimore me publikun
6	Sha UK Shkodër	Dokumentacion i paplotësuar	Mungon Vendimi i Këshillit Bashkiak, Shkodër
7	Sha UK Fier	Dokumentacion i paplotësuar	Mungojnë: raporti i ekspertit kontabël, Vendimi i Këshillit Bashkiak dhe procesverbali i seancës dëgjimore me publikun

Aplikimet e mësipërme janë subjekt i vendimmarrjes së KKRR për vitin 2018.

Në aneksin 3 dhe 4 jepen shoqëritë me tarifate aktuale, të propozuara dhe ato të miratuara nga ERRU në vitin 2017.

ERRU ka organizuar edhe takime me drejtues të shoqërive lidhur me aplikimet, ku janë diskutuar problematikat si dhe u janë lënë afate kohore për plotësimin dhe saktësimin e informacionit.

Një rregullim i mirë i sektorit ka nevojë për informacion të besueshëm. Saktësia e të dhënave luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e tarifave. Rritja e besueshmërisë së të dhënave është një nga prioritetet e punës së ERRU-së, por mbetet problem realizimi i tyre, sepse të dhënat mbledhen, përpunohen dhe administrohen nga Njësia e Monitorim Benchmarking pranë AKUK.

ERRU gjatë shqyrtimit të aplikimeve për aprovimin e tarifave të reja nga shoqëritë UK ka parasysh një kompleks faktorësh, si: shpenzimet, normën e arkëtimit, tendencën e performancës së shoqërisë, përballueshmërinë e pagesës së faturës nga konsumatorët, përbërjen e zonës së shërbimit (rurale, urbane), si dhe veçori të sistemeve të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve të UN, mosha e aseteve, gjendja e tyre, nevojat për investime urgjente dhe afatmesme, shlyerja e detyrimeve ndaj kredidhënësve për investimet e kryera etj.

ERRU ka mbështetur dhe do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet e të gjithë operatorëve për rritjen e qëndrueshmërisë financiare duke siguruar njëkohësisht për konsumatorët cilësinë më të lartë të mundshme të shërbimeve për një furnizim me ujë të sigurt nga ana sanitare, të vazhdueshëm dhe me presionin e duhur.

Shoqëritë duhet të arrijnë të mbulojnë kostot e shërbimeve që ofrojnë me të ardhurat nga aktiviteti i tyre. Tarifa luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Ndryshimi i tarifave ka pasur përgjithësisht tendencë rritëse, në varësi të kushteve dhe zhvillimeve të ofrimit të shërbimit të çdo operatori.

Theksohet fakti se ka mjaft operatorë që operojnë me tarifa të ulëta në krahasim me kufirin e përballueshmërisë së pagesës së faturës nga konsumatorët, dhe/ose mezi arrijnë të mbulojnë me të ardhurat kostot e operimit dhe mirëmbajtjes, pra të kostove direkte. Në disa raste kjo bëhet për arsye përfitimi politik duke pretenduar që diferenca e kostove të mbulohet me subvencione nga Qeveria Qendrore.

Siç u theksua më sipër, aplikimet e paraqitura për miratimin e tarifave në vitin 2017 kanë qenë të karakterit të ndryshëm, si më poshtë:

- Sh.a UK Berat-Kuçovë ka aplikuar për tarifa vetëm për zonat e reja me vlera të ndryshme nga ato të zonës ekzistuese.
- Sh.a UK Korçë aplikon për ndryshimin e tarifave për të gjithë zonën e shërbimit, por të diferencuara për zonën ekzistuese nga zona e re rurale që i është shtuar. Kjo justifikohet me faktin e nivelit dhe cilësisë së shërbimit, i cili është i ndryshëm dhe për sa kohë është i tillë dhe tarifate duhet të jenë të diferencuara.

- Sh.a U Gramsh, Sh.a UK Skrapar, Sh.a UK Maliq dhe Sh.a UK Krujë kërkojnë edhe për zonat e reja tarifave që aplikohen për zonën ekzistuese. Këto shoqëri janë ende larg mbulimit të kostove të operimit e mirëmbajtjes dhe nëpërmjet ndryshimit të tarifave kërkojnë ta përmirësojnë këtë tregues. Specifikat e ndryshme kanë bërë që dhe analizat ekonomike-teknike të jenë të ndryshme, në varësi të aplikimit.

Një vend të veçantë në aktivitetin e ERRU-së për vitin 2017 zë analiza dhe miratimi i tarifës për dy ujësjellësit më të mëdhenj të vendit, përkatësisht Sh.a UK Durrës dhe Sh.a UK Tiranë, që mbulojnë me shërbimet e ujësjellës kanalizimeve mbi 1,5 milionë banorë ose gjysmën e popullsisë së vendit, si edhe i propozimit të Sh.a UK Korçë si shoqëri pararojë në zbatim të procesit të reformës sipas VKM nr. 63. Aplikimi i Sh.a UK Durrës konsiston në mbulimin e kostove të O&M, ndërkohë që aplikimet e shoqërive UK Tiranë dhe UK Korçë, si shoqëri që i mbulojnë kostot e O&M, synojnë të mbulojnë me tarifën e propozuar edhe nevojat për investime fizike të parashikuara në planin 5-vjeçar të biznesit.

Për rëndësinë që kanë tre rastet e mësipërme, vendimmarrja për tarifën e tyre, më poshtë ato trajtohen në mënyrë më të detajuar.

Sh.a UK Durrës

Tarifat e reja për UK Durrës sh.a u aprovuan me vendim të KKRR nr. 31, datë 18.07.2017. Tarifat e miratuara nga KKRR ishin të njëjta me ato që shoqëria kishte propozuar, pra për konsumatorët familjarë nga 65 lekë/m³ në 71 lekë/m³, tarifa që synonin mbulimin 100% të kostove të O&M të shoqërisë. Dosja e propozimit të tarifave të reja për shërbimet e ujësjellës kanalizimeve nga shoqëria UK Durrës u depozitua pranë ERRU-së me 30 qershor 2016 dhe është marrë në shqyrtim nga kjo e fundit vetëm pasi ka ardhur opinioni i Këshillit Bashkiak Durrës, me datë 03.04.2017. Gjatë analizës së tarifave të propozuara nga UK Durrës sh.a, KKRR pati parasysh veçoritë e mëposhtme:

- Sistemi i furnizimit me ujë i shërben një popullsie prej rreth 400 mijë banorëve, që përkatësisht rreth 270 mijë janë në qytetin e Durrësit dhe rreth 130 mijë janë në zonën rurale (përpjesëtimi 70% me 30%). Në këto shifra nuk përfshihet shtesa mjaft e madhe e popullsisë nga turistët gjatë sezonit turistik, kryesisht në plazhin e Durrësit dhe të Gjirit të Lalzit.
- Sistemi merr ujë nga Fushë Kuqe me ngritje mekanike nga rreth 44 km larg qytetit të Durrësit, i cili gjatë rrugës furnizon me ujë të gjithë zonën rurale. Ky ujësjellës është ndërtuar në vitin 1980 për të plotësuar nevojat e një popullsie mjaft më të vogël sesa ajo e sotme, e cila është rritur në mënyrë të konsiderueshme nga migracioni i pakontrolluar i dy dekadave të fundit.
- Në lidhje me treguesin e performancës "Ujit pa të ardhura" për të gjithë zonën e shërbimit është në nivelin 72%, ndërsa për qytetin e Durrësit rezulton të jetë rreth 58%. Për zonën rurale ky tregues është në vlera mjaft të larta, shkakët e së cilës ndër të tjera janë superkonsumi dhe shpërdorimet si rezultat i marrjes së ujit direkt nga transmissioni kryesor me presion 20 atm. Këtë gjendje e vërteton edhe bilanci i ujit që tregon se konsumi i ujit për banor në total është rreth 140 l/ditë/banor për zonën e shërbimit në qytet dhe rreth 330 l/ditë/banor për zonën rurale.

- Nga ana financiare UK Durrës operon me humbje duke mbuluar vetëm 81% të kostove të O&M, diferenca e së cilës mbulohet me subvencione nga Qeveria Qendrore.
- Shoqëria ka një borxh të thelluar për energjinë elektrike. Operimi i sistemeve të furnizimit me ujë nga Fushë Kuqe (44 km larg), nga Fushë Kruja (15 km larg), 9 stacionet e pompimit të ujërave të ndotura, si dhe impianti i trajtimit të ujërave të ndotura korrespondon me një faturë të konsumit të energjisë në vlerën rreth 3 milionë euro/vit.
- Shoqëria disponon një plan biznesi 5-vjeçar, financuar nga USAID dhe aprovuar nga Banka Botërore, i cili merr parasysh financimin e një kredie prej 65 milionë euro nga kjo e fundit për investime fizike dhe institucionale në zonën e shërbimit të UK Durrës. Investimet fizike konsistojnë në ndërtimin e një ujësjellësi të ri për një prurje shtesë prej rreth 650 litra/sek nga pellgu i Fushë Kuqes me destinacion kryesisht qytetin e Durrësit, ndërkohë që ujësjellësi ekzistues do të shërbejë për zonën rurale. Investimi përfshin edhe rehabilitim të rrjetit shpërndarës të qytetit Durrës, si dhe disa ndërhyrje në zonën rurale për të eliminuar mbipresionet dhe shpërdorimet.
- Relacioni i ri i paraqitur nga UK Durrës tregoi që shoqëria kishte realizuar progres në performancë duke rritur vlerën e ujit të shitur me 7,6%, rritje të volumit total të arkëtimeve me 3,8%, si dhe rënie me 0,3% të "Ujit pa të ardhura". Nga ana tjetër, shoqëria kishte përmirësuar performancën e saj në lidhje me raportin e punës. Si tregues kryesor financiar i operimit të shoqërisë është përmirësuar nga 1,61 në 1,46, megjithëse akoma nuk kishte filluar zbatimin në praktikë të projektit.

Bazuar në të gjithë faktorët e mësipërm u pa e arsyeshme dhe e justifikueshme që në mbledhjen e KKRR, të datës 18.07.2017, të miratohen tarifat e shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve të shoqërisë UK Durrës në përputhje me ato të propozuara nga shoqëria.

Rritja tarifave të miratuara do të mbulojë 100% kostot direkte të O&M duke e çliruar Qeverinë Qendrore nga subvencioni që duhet t'i japë shoqërisë UK Durrës, si dhe do të kontribuojë dukshëm në shëndoshjen financiare të shoqërisë dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve. Njëkohësisht me aprovimin e tarifave, KKRR vendosi objektiva të reja performancë për shoqërinë, të cilat do të monitorohen rigorozisht në baza vjetore nga ERRU.

Sh.a UK Tiranë

Shoqëria e ujësjellës kanalizime Tiranë aplikoi në mesin e vitit 2017 pranë ERRU-së për një rritje të çmimeve (tarifave) për shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm, ndërsa për tarifat e largimit të ujërave të përdorura nuk u propozua asnjë ndryshim. Për konsumatorët familjarë u propozua një rritje çmimi nga 45 lekë/m³ në 65 lekë/m³, ndërsa për konsumatorët privatë dhe institucionet shtetërore u propozua një rritje shumë më e madhe. Objektivi kryesor që shoqëria synon të realizojë me këtë rritje çmimi është: ***Kryeqyteti gradualisht deri në fund të vitit të pestë do të ketë furnizim me ujë pa ndërprerje, pra 24 orë/ditë.***

Aplikimi pranë ERRU-së i UK Tirana sh.a për tarifa të reja shërbimesh, në ndryshim me atë të Durrësit, qëndron në faktin se me tarifat e reja të propozuara shoqëria kërkon të mbulojë edhe kostot e investimeve që kanë nevojë sistemet e furnizimit me ujë dhe grumbullimit dhe

largimit të ujerave të ndotura për Tiranën. Në vendimmarrjen e tij ERRU konsideroi, si më poshtë:

- Objektivi për të furnizuar me ujë qytetin e Tiranës 24 orë/ditë është një objektivi mjaft ambicioz dhe me rëndësi të veçantë për kryeqytetin që përfaqëson 1/3 e popullsisë së vendit.
- Arritja e këtij objektivi kërkon investime fizike mjaft të mëdha në sistemin e furnizimit me ujë, ku rreth 30% e të cilave parashikohet të përballohet nga rritja e propozuar e tarifës së ujit, dhe rreth 70% do të përballohet nga kreditë dhe/ose donacionet që do të merren për këtë qëllim.
- ERRU pasi shqyrtoi paraprakisht dokumentet e propozimit të shoqërisë, kërkoi sqarime në rrugët dhe mënyrat për arritjen e objektivit për një furnizim të vazhdueshëm të popullsisë, vlerësimet e investimeve të parashikuara, programet kundër lidhjeve të paligjshme, mbi humbjet administrative, si dhe sqarime të tjera të një karakteri teknik.
- Analiza e mëtejshme konstatoi që në dy vitet e fundit shoqëria ka një trend pozitiv në drejtim të përmirësimit të performancës financiare duke mbuluar mbi 100% shpenzimet e operim-mirëmbajtjes, kryesisht nga rritja e normës së arkëtimit, ndërkohë që treguesit e “Ujit pa të ardhura”, të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë të popullsisë mbeteshin akoma në vlera jo të kënaqshme.
- Tendenca në vazhdimësi e përmirësimit të performancës financiare është element mjaft i rëndësishëm për të përfutur besimin e donatorëve për të financuar, mbështetja e të cilëve është tejet e domosdoshme për të mbuluar pjesën më të madhe të investimeve kapitale që parashikon shoqëria për realizimin e objektivave të saj.
- Propozimi u shoqërua me një plan biznesi 5-vjeçar, ku jepej një skanim i situatës aktuale të treguesve të performancës së shoqërisë, shoqëruar me një analizë dhe vlerësim të secilës prej tyre. Objektivat e përcaktuara jepeshin të shoqëruara me plane të veprimit për arritjen e tyre.
- Në propozim parashikohet hartimi së shpejti i një Master Plani për zonën e shërbimit të shoqërisë, i cili do të ndihmojë me detaje të mëtejshme për zbatimin në praktikë të planeve të veprimit për të realizuar objektivat e vendosur, si dhe do të japë një pasqyrë më të qartë të nevojave për investime për një periudhë më afatgjatë mbi 20-vjeçare që do të ketë shoqëria në të ardhmen.
- U konsiderua mjaft i arsyeshëm kombinimi i eliminimit të lidhjeve të paligjshme me investimet fizike në linjat e transmissioinit nga burimi në rezervuarë për të ulur gjithashtu humbjet fizike, sepse këto linja kanë përgjithësisht presione mjaft të larta.
- Megjithatë parashikohet ulja e sasisë vjetore të ujit të prodhuar si rezultat i uljes së “Ujit pa të ardhura”, janë vlerësuar të justifikuar investimet e parashikuara për

rritjen e sasisë së prurjes së ujit në sistem si domosdoshmëri për të përmbushur kërkesën maksimale për ujë në periudhën e pikut në stinën e verës.

- Janë vlerësuar si të domosdoshme instalimi i ujëmatësve elektronikë për rreth 35,000 biznese private që paraqiten problematike në drejtim të faturimit në volumin real për sasinë e ujit që ato konsumojnë. Për këtë kategori konsumatorësh abuzimi nga ana e faturuesve me leximin e ujëmatësve klasikë është shumë i mundshëm, sepse konsumi i tyre ndryshon mjaft nga njëri tek tjetri dhe vërtetësia e leximit të tyre bëhet vetëm nga kontrolli në terren për dhjetëra mijëra klientë. Krahas eliminimit të abuzimeve të mundshme, instalimi i matësve inteligjentë sjell edhe reduktimin e numrit mjaft të madh aktual të faturuesve, sepse leximi ujëmatësve do të bëhet me pajisje elektronike.
- Financimet e investimeve kapitale mbështeten te kontributi nga tarifat, si dhe nga kreditë e bankave/donatorët. Përfshirja nga skema e granteve nga Qeveria Qendrore (taksa) e çliron këtë të fundit nga kontributi që duhet të parashikonte për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në këtë bashki. Kjo do të thotë që për përmirësimin e shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve të popullsisë në Bashkinë e Tiranës të mos paguajë i gjithë vendi, por vetëm banorët e saj që ekonomikisht përfaqësojnë pjesën e popullsisë më të ardhura më të larta në vend.
- Në skemën e financimit të parashikuar, pjesërisht nga tarifa dhe pjesërisht nga kreditë, është marrë parasysh në mënyrë të arsyeshme çështja e përballueshmërisë për pagesën e faturës së ujit nga ana e konsumatorëve. ERRU ka si referencë përballueshmërie të pagesës së faturës së ujit vlerën prej 5% të të ardhurave mesatare të një familjeje në Shqipëri që llogaritet rreth 70,000 lekë/familje, ose që nënkupton një faturë të ujit rreth 3,500 lekë/muaj. Për Bashkinë e Tiranës tarifat e propozuara për një familje prej 4 personash rezultojnë me një faturë mujore mesatare prej 1,334 lekë/familje, pra janë mjaft më të ulëta se kufiri i përmendur më sipër. ***Rritja e propozuar për konsumatorët familjarë për të pasur ujë pa ndërprerje në banesë konsiston në vetëm 14 lekë/ditë/familje.***
- Arritja e objektivit për të furnizuar me ujë 24 orë në ditë popullsinë urbane, nënkupton për një pjesë të madhe të popullsisë dhe uljen e kostove shtesë që konsumatorët duhet të paguajnë nga përdorimi i pompave individuale për të mbushur depot e tyre familjare. Të mos harrojmë se një pjesë e madhe e ujit që furnizohet Tirana është e një cilësie mjaft të lartë në drejtim të shijes dhe vlerave minerale. Rritja e besimit të popullsisë në cilësinë e ujit, për shkak të regjimit të furnizimit me ujë 24 orë në ditë do të ketë impakt në zvogëlimin e shpenzimeve për të blerë ujë të pijshëm në treg nga këto të fundit.

ERRU për konsumatorët privatë dhe ato buxhetorë ka aprovuar një rritje më të arsyeshme të tarifave duke mos thelluar më tej diferencat mjaft të mëdha që ekzistojnë aktualisht në raportin ndërmjet tyre dhe konsumatorëve të tjerë. Nga ana tjetër, nuk është aprovuar absolutisht rritja e çmimit të ujit për konsumatorët si furrat e bukës, dhe ato të shitjes së ujit me shumicë. ERRU do të ketë angazhimin maksimal për të monitoruar arritjen e objektivave që shoqëria UK Tiranë ka marrë përsipër. Monitorimi nga ERRU do të kryhet në bazë vjetore

dhe në fund të vitit të 5-të, vit i cili kjo shoqëri duhet të arrijë objektivin madhor të furnizimit me ujë 24 orë/ditë të popullsisë.

Sh.a UK Korçë

Sh.a UK Korçë në aplikimin e paraqitur kërkonte nivel tarifar për të gjithë zonën e shërbimit sipas reformës territoriale, nivel ky i ndryshëm në zonën ekzistuese nga ai i zonës rurale dhe vetë brenda zonës rurale tarifa të diferencuara. Kjo për faktin se niveli i tarifave duhet t'i përgjigjet dhe nivelit të shërbimit.

Sh.a UK Korçë shoqëroi propozimin e saj me informacion me të gjitha vlerësimet e situatës në zonën e re rurale që iu shtua zonës së mëparshme të shërbimit, si inventari dhe gjendja fizike e aseteve, investimet që ishin kryer për përmirësimin e situatës në këto zona. Propozimi shoqërohej gjithashtu edhe me përcaktimin e nevojave për investime në zonat e reja për përmirësimin e cilësisë së shërbimit, shoqëruar edhe me preventivin përkatës. Theksohet fakti që kjo shoqëri në propozimin e tarifave për këto zona ndjek parimin e rritjes graduale të tarifës, krahas kryerjes së investimeve në sistemet e tyre.

Shoqëria UK Korçë është shembulli tipik i mirëmanaxhimit të shoqërisë duke përballuar me sukses sfidat e reformës në sektorin e ujit.

1.3.2.1 Përballueshmëria

Gjatë analizës dhe vlerësimit të aplikimeve të shoqërive për tarifa shërbimi, ERRU ka parasysh aplikimin e një strukture tarifash që të jenë të përballueshme nga konsumatorët, që përputhet edhe në zbatim të pikës nr. 5 të Rezolutës së Parlamentit, aneksi 1.

Në funksion të këtij qëllimi, ERRU është duke përdorur disa instrumente rregullatore, si: struktura tarifore, subvencioni i kryqëzuar ndërmjet kategorive të ndryshme të konsumatorëve, seanca dëgjimore me publikun, si dhe riorientimet e reja të politikës në drejtim të subvencionimit të shoqërive për të mbuluar kostot operative.

Për të vlerësuar nga ana sasiore problemin e përballueshmërisë së pagesës së tarifave, Banka Botërore dhe KE përdorin si kriter për të vlerësuar përballueshmërinë konsumin mujor për person prej 3 m³ (ose 100 litra/ditë/person), dhe një nivel përballueshmërie 4% të të ardhurave mesatare të një familjeje. Në këtë vlerësim përjashtohet shtresa në nevojë e popullsisë në varfëri ekstreme që përbën rreth 2.5% të totalit të popullsisë.

ERRU përdor si kriter për përballueshmërinë e pagesës së faturës së shërbimeve UK, vlerën prej 5% të të ardhurave (shpenzimeve) mesatare të një familjeje. Në rang vendi të ardhurat mujore mesatare të përgjithshme të një familjeje (pa përfshirë atë të 10% të shtresës së pasur) vlerësohen rreth 70,000 lekë/muaj, që i korrespondon një mesatareje të përballueshmërisë së tarifave mesatare të shërbimeve të UK prej rreth 300 lekë/m³.

Këto vlera tregojnë se ka shumë hapësirë në drejtim të aftësisë paguese për të përballuar rritjen e tarifave. Në këtë vlerësim janë mbështetur dhe konkluzionet e strategjisë së

financimit të sektorit (3T) për të përballuar një pjesë të konsiderueshme të nevojave për investime (rreth 40-50% e tyre) me anë të rritjes së tarifave.

Në fakt INSTAT në vitin 2014 ka realizuar llogaritjen e të ardhurave për shtresa të popullsisë në mënyrë më të detajuar duke i ndarë ato në 10%-sha (decila). Nëse për përballueshmërinë do të konsiderojmë pjesën prej 10% të shtresës së varfër të popullsisë (jo atë në nevojë), niveli i përballueshmërisë për këtë shtresë i përgjigjet një tarife mesatare të shërbimeve prej rreth 130 lekë/m³, tarifa të cilat aktualisht janë në kufi ose tejkaluar pak vetëm për shoqëritë UK të qyteteve të Korçës dhe të Durrësit (shih aneksin 5).

Trajtimi i problemit të përballueshmërisë bazuar në të ardhurat mujore të çdo familjeje duke i konsideruar në mënyrë më të detajuar shtresat e ndryshme të popullsisë sipas 10%-shave, dhe sipas çdo qarku, është mënyra më objektive e vlerësimit të tij, mënyrë e cila jep një tablo më të qartë edhe të reagimit të pritshëm nga publiku kur propozohet rritja e tarifave, si dhe të ndërtimit të politikave sociale nga qeveria qendrore dhe ajo lokale.

ERRU ka në vëmendjen e saj në të ardhmen saktësimin e kriterëve dhe metodologjisë së marrjes në konsideratë të përballueshmërisë edhe në konsultim me shoqërinë e rregullatorëve të Europës (WAREG), si dhe të dhënave të disponueshme nga INSTAT në vendimmarrjen e saj për miratimin e tarifave që propozojnë shoqëritë UK duke pasur parasysh mbrojtjen e konsumatorëve me të ardhura të ulëta dhe njëkohësisht garantimin e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK.

1.4 Monitorimi i performancës së sektorit dhe ofruesve të shërbimit

ERRU monitoron performancën e shoqërive UK dhe të sektorit të ujit në përgjithësi në përmbushje të përgjegjësi që kanë këto shoqëri për ofrimin e shërbimeve cilësore konsumatorëve, të përballueshme si pagesa nga konsumatorët, si edhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK.

Rezultatet e monitorimit përmbledhen në botimin e raportit vjetor të performancës për shoqëritë UK, në të cilin jepet një analizë e hollësishme e performancës së çdo shoqërie, si edhe e të gjithë sektorit të ujit në Shqipëri. Ky raport shërben si bazë të dhënash dhe rekomandimesh për prioritetet e politikave strategjike në nivel të qeverisë qendrore, si dhe atyre lokale për sektorin e ujit. Raporti vjetor i performancës së shoqërive UK për vitin 2016 u hartua dhe u botua në mesin e muajit korrik 2017.

Monitorimi i sektorit UK dhe publikimi i raportit të performancës që ERRU publikon çdo vit ka për qëllim dhënien e mundësisë për të gjithë aktorët e interesuar, duke përfshirë edhe vetë konsumatorët, që të shohin progresin e arritur në këtë sektor dhe të vlerësojnë performancën e operatorit të tyre lokal, duke përbërë kështu një stimul të fuqishëm për përpjekjet e operatorëve për të përmirësuar ofrimin e shërbimit. ERRU bën përpjekjet maksimale që ky raport të jetë sa më sintetik dhe objektiv në vlerësimet dhe rekomandimet që jepen në të.

Procesi i monitorimit që ndiqet nga ERRU është një proces i vazhdueshëm, analizat e të cilave mbështeten në korrespondenca dhe vizita periodike në shoqëritë UK dhe bashkitë përkatëse, si përgjegjëse ligjore të ofrimit të shërbimit konsumatorëve. Në veçanti monitorimi paraqitet i domosdoshëm për t'u realizuar gjatë procesit të vlerësimit të propozimeve të shoqërive UK për tarifa të reja, si dhe të plotësimit të kushteve të licencës.

Theksohet fakti që në praktikën e mëparshme, hartimi dhe botimi i këtij raporti realizohen jo më parë se fundi i tetorit të vitit pasardhës. Botimi i tij në këtë afat ishte formal në kuptimin e pamundësisë së marrjes parasysh dhe zbatimit në kohë të rekomandimeve që jepen në raport për vitin në vazhdim. ERRU mori angazhim dhe e shkurtoi në maksimum afatin e realizimit të tij, praktikë të cilën do ta ndjekë edhe për hartimin e raportit vjetor të performancës 2017. Nënvizohet fakti se të dhënat për hartimin e raportit vjetor/9 muajor të performancës ERRU i merr nga Njësia e Monitorim Benchmarkut pranë AKUK. Duke pasur parasysh problemet e saktësisë së të dhënave, si dhe të lidhjes organike dhe direkte të veprimtarisë së ERRU-së me shoqëritë UK, rekomandohet të konsiderohet mundësia që kjo njësi të kalojë pranë ERRU-së.

1.5 Përmirësimi i standardeve në sektorin UK nëpërmjet instrumenteve rregullatore

Një nga kompetencat e Komisionit Kombëtar Rregullator është miratimi i rregullave për të ndihmuar në ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve të tij të parashikuara në ligj. Në këtë drejtim, ERRU gjatë vitit 2017 ka vijuar me punën për të përmirësuar instrumentet rregullatore që lidhen me aplikimin për ndryshimin e tarifave, si dhe për t'i bërë problematikat më të pranishme të sektorit dhe ato që kanë lidhje me konsumatorin. Në këtë kuadër ERRU ka rishikuar dhe miratuar dokumentet e mëposhtme.

- **"Udhëzuesi për organizimin e seancës dëgjimore me publikun"**, i cili në përmbushje të procesit të transparencës ka përmirësuar procedurat që duhet të ndiqen nga operatorët për organizimin e seancës dëgjimore me publikun (vendimin nr. 37, datë 06.09.2017). Nga eksperiencia e zhvillimit të seancave dëgjimore u konstatuan se udhëzuesi aktual kishte mangësi në drejtim të orientimit për zhvillimin e një seance dëgjimore praktike dhe efikase për një komunikim dhe përfitim të opinionit publik në lidhje me problematikat e shërbimeve që ofron shoqëria, si edhe të nivelit të tarifave që ajo propozon të aplikojë.
- **"Modeli i formularit të informacionit teknik"** që shoqëritë duhet të depozitojnë në ERRU, si pjesë e data base në mbështetje të dokumentacionit qoftë kur aplikohet për tarifa të reja, si edhe për licencë. Ky informacion konsiderohet i domosdoshëm për një analizë dhe vlerësim të drejtë të situatës teknike dhe të operimit të shoqërisë që lidhet me kostot dhe shpenzimet përkatëse të tyre si pjesë e propozimit për tarifa të reja.
- **"Tabela dhe udhëzime ndihmëse"** për shoqëritë që po riorganizohen në mbështetje të plotësimit të dokumentacionit për asetet që duhen të merren në dorëzim nga shtesa e zonës së shërbimit, kryesisht për zonat rurale. Nisur nga mungesa e informacionit për asetet në zonat rurale shtesë, këto tabelat e udhëzime ndihmëse kanë karakter të thjeshtësuar e praktik për të mbledhur informacionin maksimal të mundshëm për sasinë dhe gjendjen e aseteve të zonave rurale. Ky informacion përbën një element të domosdoshëm për të justifikuar aplikimet e tarifave të reja për zonat e reja shtesë të shërbimit të unifikuara apo të diferencuara.
- **"Forma e kontratës ERRU-shoqëri UK"** që nënshkruhet ndërmjet palëve, mbasi ERRU ka miratuar tarifat e reja për shoqërinë. Kontrata e rishikuar plotëson dhe saktëson kushtet e objektivave dhe të monitorimit të tyre, si dhe të marrëdhënieve e detyrimeve financiare ligjore të shoqërisë ndaj ERRU-së.
- **"Rregullore e inspektimit të veprimtarisë së shoqërive UK që veprojnë në sektorin e ujit"**. Rregullorja e rishikuar, krahas plotësimeve me detaje praktike të metodologjisë, të fushave dhe procedurave të inspektimit, jep një format të ri të rishikuar të raportimit të plotësuar me të gjitha detajet e nevojshme në lidhje me (mos) plotësimin ndër të tjera të standardeve teknike të operimit, menaxhimit financiar, si dhe të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve. Një aspekt i rëndësishëm i këtij dokumenti do të jetë rregullimi i procesit të monitorimit të shoqërive ujësjellës kanalizime.

Gjithashtu në fund të vitit 2017 u ngrit grupi i punës, i cili do të punojë mbi rishikimin e "Metodologjisë së vendosjes së tarifave". Rishikimi i metodologjisë aktuale vjen si nevojë e reformës së ndodhur në sektorin UK, ku gjatë aplikimeve për nivel të ri tarifor të shoqërive të riorganizuar kemi hasur në disa problematika të reja, të cilat kanë nevojë për t'u rregulluar sipas një metodologjie të re. Metodologjia e re do të përfshijë aspekte të reja cilësore në përputhje me kërkesat në rritje të sektorit të ujit që kanë lidhje jo vetëm me metodologjinë e miratimit të tarifave për të mbuluar kostot e O&M, por edhe ato të investimeve. Miratimi i metodologjisë së vendosjes së tarifave, i rishikuar, është planifikuar të përfundojë në vitin 2018.

1.6 Bashkëpunimi dhe marrëdhëniet ndërinstitucionale të ERRU-së

Bashkëpunimi i rregullatorit me aktorët që operojnë në sektorin e ujit është një nga instrumentet kryesore në përmbushje të plotë të mandatit dhe misionit të tij. Nisur nga ky këndvështrim, ERRU ka bashkëpunuar ngushtësisht me institucionet e tjera të vendit, rajonit e më gjerë për të krijuar një mjedis rregullator, i cili ndihmon në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar në sektorin ujësjellës kanalizime.

1.6.1 Bashkëpunimi me institucionet kombëtare

Enti Rregullator i Ujit, përgjatë vitit 2017, ka vijuar bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë, duke informuar dhe pasqyruar veprimtarinë institucionale të rregullatorit si dhe të gjendjes së sektorit të ujit nëpërmjet raportimit në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit. Marrëdhënia me këtë komision nuk ka qenë e kufizuar vetëm në raportimin, por në kontakte dhe konsultime të vazhdueshme në trajtimin dhe mbështetjen për problematikat e ndryshme të sektorit të ujit në përgjithësi, si dhe të ushtrimit e forcimit të rolit të ERRU-së në veçanti.

Në kuadër të fillimit të zbatimit të mekanizmit ndërinstitucional për forcimin e sistemit të monitorimit të të dhënave dhe rekomandimeve të institucioneve të pavarura, bashkëpunimi me Kuvendin është intensifikuar në takimet e organizuara nga Kryetari i Kuvendit me institucionet e pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj dhe me raportimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në rezolutën e Kuvendit për vitin 2016.

Edhe gjatë vitit 2017, ERRU ka bashkëpunuar ngushtësisht me MIE në kuadër të riorganizimit të sektorit të ujit dhe reformës së ndërmarrë nga Qeveria Qendrore. ERRU, si një aktor i rëndësishëm në sektor, ka kontribuar përmes propozimeve dhe qëndrimeve zyrtare në evidentimin dhe përmirësimin e problematikave që ka sot sektori i ujit në kuadër të reformës, si dhe rishikimin e dokumenteve sektoriale. Kontribut të veçantë ERRU ka dhënë në hartimin e draft-kontratave të performancës ndërmjet MIE dhe bashkive përkatëse, si dhe të përcaktimit dhe mënyrës së vlerësimit të treguesve të performancës që duhet të përfshihen në këto kontrata. Gjithashtu ERRU ka mbështetur në çdo hap me rekomandime si dhe

nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në takime apo grupe pune për të arritur në një qasje sektoriale që ka në fokus të saj ofrimin e shërbimit sipas standardeve.

Enti Rregullator i Ujit, si pjesë e grupit për Menaxhimin e Integruar të Politikave - nëngrupi tematik "Ujë për njerëz" - dhe një nga aktorët kyçë në infrastrukturën institucionale të sektorit, ka vijuar kontributin me sugjerime mbi draftin final të Programit Kombëtar Sektorial (PKS) 2018-2030 të iniciuar nga Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, si një nga prioritetet bazë të qeverisë shqiptare.

Edhe për vitin 2017 ka vijuar bashkëpunimi dhe procesi konsultativ me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nëpërmjet pjesëmarrjes në grupet ndërinstitutionale të punës për hartimin e kadastrës ujore dhe përgatitjes së planeve të menaxhimit të baseneve ujore Drin, Buna, Seman dhe Shkumbin në kuadër të projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes të mbështetura me ekspertizë nga donatorë të huaj.

Në vijim të bashkëpunimeve institucionale për çështje që prekin sektorin e ujit, një vëmendje e veçantë në vitin 2017 iu kushtua bashkëpunimit me Ministrinë e Shëndetësisë dhe përkatesisht me Inspektoratin Sanitar Shtetëror mbi propozimet për ndryshimet ligjore që duhet të ndërmerren për përmirësimin e rregullave në marrjen e akt-miratimit higjeno-sanitar nga shoqëritë ujësjellës kanalizime. Ky rregullim u pa i nevojshëm që të ndërmerret nga konstatimi i një sërë problematikash të lidhura me këtë akt për të garantuar cilësinë e ujit të pijshëm, ndërmjet të tjerave:

- Hartimin dhe miratimin e një standardi të unifikuar të formatit që shoqëritë e UK duhet të plotësojnë për çdo element të sistemeve të furnizimit me ujë, si kusht për t'u plotësuar prej tyre për t'u pajisur me licencë nga ERRU-ja;
- Rishikimi i penaliteteve për personat përgjegjës, kur tejkalon afati i vlefshmërisë së licencës dhe shoqëria nuk ka aplikuar për rinovim licence pranë ERRU-së.

Në vitin 2018, ERRU do të vazhdojë iniciativën për të ngritur grupin e punës me përfaqësues nga MIE dhe Ministria e Shëndetësisë, për të realizuar propozimet për ndryshimet e nevojshme ligjore.

Gjithashtu në kuadër të nismës së Ministrisë së Shëndetësisë për përcaktimin e skemës së subvencionimit të ujit të pijshëm për familjet në nevojë, në zbatim të programit 300 ditor të Reformës për Mirëqeverisjen e Ujit, ERRU ka bashkëpunuar ngushtësisht me grupin ndërinstitutional të punës me përcjellje informacioni dhe propozime mbi krijimin dhe zbatimin e kësaj skeme subvencionimi.

Një rëndësi të veçantë përgjatë vitit 2017 ka marrë edhe bashkëpunimi i ERRU-së me donatorët e huaj që japin kontributin e tyre në sektorin e ujit në Shqipëri.

Kështu, ERRU është ftuar të marrë pjesë në takimet që zhvillojnë donatorët për të diskutuar dhe shkëmbyer zhvillimet më të rëndësishme në sektor dhe për të përditësuar aktivitetet ose projektet e reja. Gjatë takimit të fundit, ERRU ka mbajtur një prezantim dhe ka shprehur këndvështrimin e saj se ku qëndrojnë sfidat e vetë rregullatorit dhe të sektorit në tërësi në kuadër të reformës së ujit.

ERRU, në vitin 2017, mori pjesë në konferencën me titull "Shqipëria-Hungaria - Lidhja e bizneseve dhe profesionistëve të ujit", të organizuar nga Ambasada Hungareze dhe shoqatat e ujit të të dy vendeve, me qëllim ofrimin e një platforme efektive për diskutim dhe për të forcuar bashkëpunimin dhe transferimin e njohurive ndërmjet profesionistëve të ujit dhe bizneseve të të dy vendeve. Kryetari i ERRU-së mbajti një prezantim për të pranishmit mbi performancën aktuale të sektorit UK në Shqipëri dhe nevojave për ndërhyrje.

1.6.2 Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare

Pjesëmarrja aktive në organizatat dhe aktivitetet ndërkombëtare është vlerësuar nga ERRU si një nga veprimtaritë kryesore të zhvillimit të mëtejshëm institucional, rritjes së kapaciteteve profesionale të punonjësve të saj, por edhe krijimit të një eksperience rregullatore ndërkombëtare. Këtu mund të përmendim aktivitetin dhe rolin e ERRU-së në anëtarësimin dhe pjesëmarrjen aktive në organizatat ndërkombëtare, *workshop*-eve apo konferencave ndërkombëtare në fushën e ujit.

1.6.2.1 ERRU anëtare e organizatave europiane dhe ndërkombëtare

Enti Rregullator i Ujit është anëtare me të drejta të plota i rrjetit të rregullatorëve europianë të ujit WAREG, rrjet i cili në vitin 2017 u regjistrua dhe ka statutin e tij si shoqatë jofitimprurëse nën ligjin italian. Aktualisht në këtë rrjet janë 25 shtete anëtare nga e gjithë Europa dhe katër shtete janë ende në statusin e vëzhguesit të këtij rrjeti. Bashkëpunimi, shkëmbimi i eksperiencës ndërkombëtare, analizat e përbashkëta, krahasimi i modeleve rregullatore, apo promovimi i praktikave më të mira janë misioni i këtij rrjeti.

ERRU me përfaqësues të niveleve të larta ka marrë pjesë në takimet e asamblesë së këtij rrjeti duke u njohur më nga afër me eksperiencat rregullatore të shteteve pjesëmarrëse. Gjithashtu ka qenë mjaft aktive duke dhënë kontributin në pasqyrimin e eksperiencës rregullatore shqiptare në takimet e grupeve të punës për çështjet e vlerësimit të indikatorëve kryesore të performancës dhe përballueshmërisë.

ERRU, si anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit (IWA), ka marrë pjesë në disa konferenca ndërkombëtare të zhvilluara nga kjo shoqatë. Interesi i ERRU-së për këtë vit u fokusua në disa aspekte specifike të fushës së ujit që vijnë në kuadër të riorganizimit të sektorit të ujit në Shqipëri, siç janë menaxhimi i aseteve dhe vlerësimi i performancës dhe benchmark i shoqërive UK.

ERRU ishte pjesëmarrës në konferencën mbi infrastrukturën dhe menaxhimin e aseteve për ujin dhe ujërat e ndotura, të organizuar nga IWA në Norvegji, një konferencë e cila i vuri theksin nevojës për një mirëmenaxhim të aseteve në sektorin e ujit në kushtet e një ekonomie të fortë dhe rritjes së kërkesave të konsumatorëve. Gjithashtu me mjaft interes nga ERRU u ndoq konferenca e specialistëve mbi vlerësimin e performancës dhe benchmark në Vjenë të Austrisë.

Edhe për këtë vit, ERRU vijoi bashkëpunimin si anëtare dhe në nivel përfaqësimi në aktivitete të veçanta me programin e ujit për rajonin e Danubit dhe rrjetit DANUBIS, të mbështetur nga Banka Botërore dhe Shoqata Ndërkombëtare e Shoqërive Ujësjellës Kanalizime. Ky program për këtë vit u fokusua te përditësimi dhe përmirësimi i rrjetit për shfaqjen e të dhënave benchmark të çdo vendi dhe në këtë kuadër ERRU kontribuoi që të dhënat për shoqëritë ujësjellës kanalizime në Shqipëri të përditësoheshin dhe informacioni të ofrohej edhe në gjuhën shqipe. Gjithashtu, ERRU mori pjesë në konferencën e ujit që zhvilloi ky program në kuadër të nxitjes së dialogut midis vendeve pjesëmarrëse për evidentimin e sfidave në financimin e zhvillimeve në sektorin e ujit në Vjenë të Austrisë. E veçanta e këtij viti për këtë program ishte organizimi i një aktiviteti në Bukuresht të Rumanisë, dedikuar menaxhimit të ujërave të ndotura dhe ndikimit në mjedis, një çështje mjaft sensitive në ditët e sotme.

ERRU, gjatë vitit 2017, mori pjesë edhe në takimin e radhës së Rrjetit të Rregullatorëve Ekonomikë (NER), të krijuar nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). Takimi u fokusua mbi rolin e rregullatorëve si aktorë të rëndësishëm në infrastrukturën e qeverisjes, duke prezantuar eksperiencat rregullatore nga e gjithë bota. ERRU në vijim të këtij takimi ka kontribuar me dhënien e mendimeve mbi raportin final të këtij rrjeti, mbi rolin e rëndësishëm që ka rregullatori ekonomik në të gjithë procesin e qeverisjes së sektorit të ujit dhe gjetja e rrugës së përbashkët midis politikave sektoriale dhe politikave të rregullatorit.

Gjithashtu, ashtu sikurse çdo vit, ERRU mori pjesë në mënyrë aktive me prezantime dhe moderime në konferencën e përbashkët ballkanike të organizuar nga SHUKALB dhe SHUKOS. Tematika e këtij viti iu dedikua "Sfidave të ujit të ndotur", një temë mjaft e trajtuar edhe në konferenca të tjera ndërkombëtare.

1.6.2.2 Marrëdhëniet bilaterale të ERRU-së

Gjithashtu përgjatë këtij viti, ERRU zhvilloi takimin e ndërsjellë me rregullatorin e Kosovës për shkëmbimin e eksperiencës rregullatore mbi tarifat, vlerësimin të performancës apo mbrojtjes së konsumatorit. ERRU zhvilloi edhe një *workshop* mjaft të frytshëm me përfaqësues nga rregullatori multisektorial i Italisë (AEEGSI) për të përfituar nga eksperiencia e tyre rregullatore për vendosjen e tarifave dhe metodologjinë që përdorin në përcaktimin e tyre. Gjatë këtij *workshop*-i përfaqësuesve të rregullatorit të Italisë iu propozua edhe nënshkrimi i një memorandum bashkëpunimi midis rregullatorëve, me qëllimin e përbashkët të shkëmbimit të eksperiencave rregullatore. Në këtë kuadër synohet që gjatë vitit 2018 pjesëtarë të stafit të ERRU të trajnohen pranë AEEGSI në detaje praktike të analizës dhe vlerësimit të propozimeve për tarifa të reja, sidomos kur kërkohet të mbulohen me tarifa nevojat për investime në sektor, si edhe të problemeve dhe praktikave të licencimit që kërkohet të përmirësohen nga ERRU.

Të njëjtën marrëdhënie bashkëpunimi ERRU do të intensifikojë edhe me rregullatorin e Skocisë (WICS), me të cilin ERRU ka një marrëveshje bashkëpunimi. Për vitin 2018 ERRU synon organizimin e një *workshop*-i kryesisht në lidhje me eksperiencën e tyre të metodologjisë së tarifave në kuadër të agregimit të shoqërive UK.

1.7 Transparenca dhe marrëdhëniet e ERRU-së me publikun dhe median

Komunikimi i drejtpërdrejtë dhe transparent me publikun për problemet apo zhvillimet në sektorin e ujit sjell jo vetëm përçimin e informacionit tek ata, por edhe ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë jetike të këtij sektori. Në të njëjtën kohë, përmirëson transparencën e rregullatorit si një nga parimet bazë për të arritur vizionin e ERRU-së.

Gjatë vitit 2017, komunikimi me mediat është realizuar nëpërmjet artikujve të botuar në gazeta apo revista ekonomike, intervistave, pjesëmarrjes në programe të ndryshme televizive, ku mund të veçojmë botimin e artikujve: "Çmimi dhe përballueshmëria e shërbimit të largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura" apo "A duhet paragjykuar rritja e çmimit të ujit të propozuar nga shoqëritë UK?".

Në detaje çështjet më kryesore që kanë ngjallur interesimin e mediave kanë qenë tarifat dhe miratimi i tyre, cilësia e ujit apo përmirësimi i shërbimit ndaj konsumatorit. Gjithashtu ERRU është kujdesur që të pasurojë dhe të përmirësojë me informacione të nevojshme edhe faqen zyrtare të internetit mbi të gjithë veprimtarinë institucionale të rregullatorit.

1.8 Të ardhurat dhe shpenzimet e ERRU-së

1.8.1 Të ardhurat

Burimet e financimit të aktivitetit të veprimtarisë së ERRU, sikurse përcaktohet në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996. "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", janë pagesat e rregullimit, të detyrueshme për operatorët që operojnë në sektor. Ato përbëhen nga pagesat rregullatore vjetore dhe pagesat për licencime të vendosura nga vetë rregullatori.

Enti Rregullator i Ujit, në përputhje me ligjin, ka nënshkruar kontrata me operatorët për aplikimin e tarifave të miratuara, ku është përcaktuar pagesa rregullatore vjetore dhe afatet e likuidimit. Detyrimi vjetor i pagesave rregullatore për vitin 2017, mbështetur në kontratat përkatëse me shoqëritë, është në shumën **46,529,670 lekë**. Kjo vlerë përllëgaritet vetëm nga pagesat rregullatore vjetore të shoqërive që operojnë me tarifa të miratuara nga rregullatori.

Aktualisht, në mbyllje të vitit rezultojnë 18 shoqëri, të cilat nuk operojnë me tarifa të miratuara nga ERRU e për rrjedhojë nuk kanë kontrata si dhe pagesë rregullatore. Konkretisht këta operatorë janë si më poshtë në tabelën 3.

Tabela 3. Operatorët pa pagesë rregullatore dhe pa detyrime ndaj ERRU-së.

Operatorë pa pagesë rregullatore			
1	Sh.a U Belsh	10	Sh.a U Kamzë
2	Sh.a U Cërrik	11	Sh.a UK Patos
3	Sh.a U Divjakë	12	Sh.a U Pustec
4	Sh.a U Fushë Arrëz	13	Sh.a UK Malësi e Madhe
5	Sh.a U Has	14	Sh.a U Himarë
6	Sh.a UK Kukës	15	Sh.a U Tropojë
7	Sh.a U Këlcyre	16	Sh.a U Vorë
8	Sh.a U Mallakastër	17	Sh.a U Roskovec
9	Sh.a U Libohovë	18	Sh.a U Vau i Dejës

Të ardhurat totale të realizuara gjatë vitit 2017 janë në shumën **49,550,514 lekë**, prej të cilave **48,290,514 lekë** janë nga pagesat rregullatore dhe **1,260,000 lekë** nga pagesat për licencimet. Krahësuar me planifikimin e detyrimeve vjetore të arkëtimeve prej **46,529,670 lekë** rezulton që gjatë vitit 2017 janë mbledhur plus **3,020,844 lekë** nga detyrimet e prapambetura që shoqëritë UK kanë pasur ndaj ERRU-së.

Të ardhurat e realizuara në vitin 2017 garantuan tërësisht mbështetjen financiare për ushtrimin e aktivitetit vjetor të Entit, duke mbuluar tërësisht shpenzimet vjetore të tij.

Në vijimësi KKRR ka treguar kujdes të veçantë në përcaktimin e pagesave rregullatore vjetore në përpjesëtim të drejtë me të ardhurat e operatorëve që operojnë në sektorin UK dhe gjithashtu të mjaftueshme për përballimin e shpenzimeve operative vjetore të ERRU. Aktualisht pagesat rregullatore variojnë nga 0.6-0.8 % të të ardhurave vjetore të parashikuara të operatorëve.

Prej disa vitesh pagesat rregullatore kumulative të pashlyera të shoqërive UK rezultojnë në shumën **86,639 mijë lekë**. Arsyet e kësaj shume mjaft të lartë detyrimesh kanë ardhur nga disa faktorë, si më poshtë:

- ERRU për të garantuar shumën e buxhetit të nevojshëm për aktivitetin e ERRU-së për vitin pasardhës, në disa raste ka planifikuar shifra të larta që në fund mosrealizimi në total i tyre nuk ka cenuar shumën e nevojshme për aktivitetin e ERRU-së;
- ERRU ka lidhur kontrata për detyrimet ndaj saj me shoqëri mjaft të dobëta nga ana financiare që në disa raste ato nuk garantonin as pagat e punonjësve të tyre;
- Edhe në rastet kur ERRU ka ndjekur rrugën gjyqësore, këto procese kanë marrë mjaft kohë dhe në disa raste shoqëritë i kanë pasur llogaritë të bllokuara, për shkak të debive të tjera.

Gjithashtu gjatë këtij viti janë shfaqur problematika edhe në kuadër të riorganizimit të operatorëve UK në përputhje me reformën administrative. Deri tani në asnjë rast ekspertët kontabël, të ngarkuar për ndarjen e asetëve dhe detyrimeve të operatorëve që po riorganizohen, nuk janë shprehur në lidhje me detyrimet e pagesave rregullatore të këtyre subjekteve, duke krijuar vështirësi në përcaktimin dhe ndarjen e detyrimeve të kontraktuara.

Në mbyllje të vitit 2017, nga 32 shoqëri që rezultojnë me detyrime të pashlyera, vetëm 5 prej tyre detyrohen për shumën **70,852,477 lekë**, vlerë që përlogaritet në masën 82% të detyrimit të përgjithshëm të pashlyer të të gjithë operatorëve, që jepen më poshtë në tabelën 4, ku paraqiten detyrimet e këtyre pesë shoqërive deri më 31.12.2017.

Tabela 4. Detyrimet e 5 shoqërive që përbëjnë peshën kryesore ndaj detyrimit total

Shoqëria	Detyrimi në lekë 31.12.2017
• Sh.a UK Durrës	7,382,207
• Sh.a UK Fier	10,078,670
• Sh.a UK Kavajë	5,311,600
• Sh.a UK Pogradec	3,220,000
• Sh.a UK Tiranë	44,860,000

ERRU gjithsesi është duke ndjekur nga afër mundësinë e realizimit të pagesës rregullore të akumuluar dhe të papaguar duke e shtrirë atë brenda një afati kohor të arsyeshëm, gjë e cila do të përfshihet në kontratën me shoqëritë përkatëse UK. Mbledhja e detyrimeve të prapambetura duket e realizueshme veçanërisht për shoqëritë e mëdha UK Tirana, UK Durrës dhe UK Fier që përbëjnë pjesën më të madhe të detyrimit të akumuluar.

ERRU për rritjen e sigurisë dhe efikasitetit në pagesat rregullore ka rishikuar formën e kontratës që ERRU lidh me shoqërinë UK, kur aprovon tarifatat duke sanksionuar më mirë detyrimin dhe mënyrën e shlyerjes së saj nga shoqëria UK.

ERRU gjithashtu po mbledh informacionin e nevojshëm mbi gjendjen e secilës shoqëri UK, gjendjen financiare të tyre, që edhe shoqëritë me aftësi paguese të pakta të ngarkohen me një detyrim pagese rregullore të arsyeshme, të cilat ato mund ta përballojnë. Kjo sepse pavarësisht aftësive të tyre paguese, ato duhet të njohin marrëdhënien financiare me ERRU që ofron shërbime për to.

Shlyerja e detyrimeve të pagesës ndaj ERRU-së për licencimin ka qenë e rregullt, si për shkak të vlerës së vogël të saj edhe si detyrim paraprak i shoqërive UK për të tërhequr licencën e aprovuar nga KKRR.

1.8.2 Shpenzimet operative

Administrimi i vlerave materiale e monetare në ERRU kryhet në përputhje të plotë me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik" dhe rregullores së brendshme të ERRU "Për menaxhimin e aktiveve".

Plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU-së propozohet nga ajo vetë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura".

Plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU-së, për vitin 2017, është miratuar me VKM nr. 939, datë 28.12.2016, “Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2017, të Entit Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”.

Në total plani i miratuar është në shumën **47,323,000 lekë** dhe i detajuar në katër zërat kryesorë: paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, shërbime e furniturë dhe investime, në raporte që paraqiten në figurën 3, si më poshtë:




Figura 3. Struktura e planit të shpenzimeve operative të vitit 2017

KKRR me vendimin nr. 1, datë 13.01.2017, ka detajuar planin vjetor të miratuar nga Këshilli i Ministrave në artikuj të shpenzimeve në përputhje me nevojat e domosdoshme për të garantuar mbështetjen logjistike për përmbushjen e objektivave vjetorë të ERRU-së, zhvillimin e veprimtarive të parashikuara dhe funksionimin normal të veprimtarisë së përditshme.

Në planin vjetor të Entit, shpenzimet për personelin (paga + sigurime shoqërore) përbëjnë 75% të totalit të planit vjetor të shpenzimeve dhe 25% janë shërbime e furniturë dhe investime.

Shpenzimet buxhetore të kryera për ushtrimin e aktivitetit të veprimtarisë vjetore të Entit gjatë vitit 2017, janë në shumën **34,761 mijë lekë, ose 73% të fondit të planifikuar të shpenzimeve operative**. Realizimi në këtë përqindje ka ardhur kryesisht nga influenca e mosrealizimeve në fondet e parashikuara në zërat paga e sigurime shoqërore dhe shërbime e furniturë.

Shpenzimet e kryera të detajuara dhe në përqindje të realizimit paraqiten si më poshtë:

- **24,227 mijë lekë**, shpenzime për pagat e punonjësve. (80%)
- **3,002 mijë lekë**, shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore. (60%)
- **7,259 mijë lekë**, shpenzime për shërbime e furniturë. (65%)
- **274 mijë lekë**, shpenzime për investime. (35%)

si dhe në formë grafike paraqitet në figurën 4.




Figura 4. Plani i shpenzimeve të miratuara nga KM me shpenzimet e realizuara

Në detaje, arsyet e uljes së shpenzimeve në krahasim me ato të planifikuara, janë si më poshtë:

- Fondet e pagave e shpërblimeve, sigurimeve shoqërore, janë realizuar në nivelet respektivisht 80% dhe 60% të fondit të planifikuar, si rezultat i mosplotësimit të të gjitha funksioneve në organikë që në fillim të vitit, sikurse janë planifikuar.
- Fondi i planifikuar në zërin “shërbime e furniturë” është realizuar në masën 65%. Gjatë këtij viti, krahasimisht me vitin e kaluar, janë ulur ndjeshëm shpenzimet e këtij zëri, megjithëse janë siguruar kushtet e mjetet optimale të punës, si dhe një bazë materiale logjistike e domosdoshme për përmbushjen e detyrave funksionale të komisionit dhe gjithë stafit punonjës. Kryesisht rezultojnë me ulje shpenzimet në artikujt: shpenzime udhëtimi brenda vendit, konsumi i karburantit, shpenzime të telefonisë fikse, shpenzime të ndryshme mirëmbajtjeje etj. Kjo është arsyeja që në planin e vitit 2018 kemi planifikuar shpenzime të ulura, në zërin “shërbime e furniturë”, krahasimisht me vitet e mëparshme.
- Zëri "investime" është realizuar në masën 35%. Diferenca e mbetur pa shpenzuar është rezultat i kursimeve nga prokurimet për rikonstruksionin e zyrave, si dhe mosrealizimi i një procedure prokurimi për mungesë të produktit në treg (rafte metalike të arkivave).

Në mbyllje të vitit, gjendja e mjeteve financiare të disponueshme në llogarinë bankare të Entit, garanton plotësisht buxhetin e vitit 2018 të miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe teprica do të derdhet në buxhetin e shtetit.

2. Gjendja në sektorin ujësjellës kanalizime

2.1 Gjendja e performancës së sektorit UK për vitin 2017

Bazuar në kompetencat që i jep ligji, ERRU monitoron dhe analizon në mënyrë të vazhdueshme gjendjen dhe performancën e sektorit në tërësi dhe të secilit operator që ofron shërbim të furnizimit me ujë, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

Enti Rregullator i Ujit është ligjërisht i mandatuar të paraqesë çdo vit "gjendjen në sektor dhe rekomandimet e tij në lidhje me masat që duhet të merren për përmirësimin e këtij sektori".

Monitorimi dhe analiza bëhet mbi bazën e *treguesve kryesorë të performancës*, të miratuar nga KKRR.

Raporti pasqyron dhe analizon gjendjen, performancën dhe tendencën e zhvillimit të sektorit UK për vitin 2017. Analiza e plotë dhe individuale për secilën shoqëri UK do të jepet në "Raportin e performancës për shoqëritë UK për vitin 2017" që përgatit ERRU mbasi të disponohen të dhënat e plota e përfundimtare të aktivitetit njëvjeçar të tyre. Tabela 5 jep vlerat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2017 dhe tendenca e tyre krahasuar me vitin paraardhës.

Tabela 5. Treguesit kryesorë të performancës

Nr.	Treguesit	Njësia	2014	2015	2016	2017	Tendenca
1	Mbulimi me ujë	%	80.8	81	79	78.67	=
2	Mbulimi me kanalizime	%	51	50	50	50	=
3	Mbulimi i kostove O&M	%	122.5	102	118	113	↘
4	Norma e arkëtimit	%	91	92	92	84	↘
5	Niveli i matjes	%	61.2	64	64	68	↗
6	Ujë pa të ardhura	%	67.2	67	67	65	↗
7	Efiçenca e stafit (stafi/1000 lidhje uji)	nr.	8.9	8.64	8.3	9.23	↘
8	Kohëzgjatja e furnizimit me ujë	orë/ditë	12.1	12.1	11.4	11.4	=

Vlerat e treguesve kryesorë të performancës në tabelën e mësipërme janë llogaritur në bazë të të dhënave të 9 mujorit të vitit 2017 të ekstrapoluara për kohëzgjatjen vjetore të tyre. Siç shihet nga tabela, vlerat e treguesve kryesorë të performancës kanë ndryshime në vlera mjaft të vogla në krahasim me vitin paraardhës, gjë që tregon që sektori vazhdon të performojë në gjendje stanjacioni me një tendencë të lehtë përkeqësimi. Një nga arsyt kryesore të kësaj tendence në rënie të performancës është se viti 2017 ka qenë një vit elektorale, që zakonisht shoqërohet me shtim artificial të numrit të punonjësve në shoqëritë e ujësjellësve (rriten shpenzimet), si dhe të një rënie të vullnetit të zbatimit të ligjit që reflektohet në uljen e normës së arkëtimit.

Në përgjithësi treguesit kryesorë të performancës kanë ndërruar nga njëri-tjetri. Vlerat e secilit prej treguesve kryesorë të performancës për sektorin dhe interpretimi i tyre duke i krahasuar me vitin paraardhës 2016, jepet si më poshtë:

"Mbulimi me ujë" dhe **"Mbulimi me kanalizime"**, si tregues kanë një përkeqësim të vogël që ka si shkak kryesor shtimin në zonën e shërbimit të shoqërive të popullsisë së zonave rurale në territorin e ri administrativ, të cilat kanë një tregues mbulimin me ujë më të vogël se ajo e zonave urbane. Mbulimi me ujë në total është rreth 78.67% i ndarë sipas zonave urbane dhe rurale është, përkatësisht 91.77% për zonën urbane dhe 59.16% në atë rurale, ndërsa mbulimi për kanalizimet e ujërave të ndotura është në total 50.01%, i ndarë për zonën urbane 75.4% dhe atë rurale 12.23%.

"Mbulimi i kostos së operimit dhe mirëmbajtjes" ka pësuar një përkeqësim me 5% krahasuar me vitin paraardhës. Shkaku i përkeqësimit të këtij treguesi lidhet si me rritjen e shpenzimeve, kryesisht nga rritja e numrit të punonjësve, energjisë elektrike dhe indeksi i inflacionit. Treguesi "mbulimi i kostove O&M" shpreh se deri në çfarë mase kostot e drejtpërdrejta si kostot për personelin, energjinë, kimikate dhe kosto të tjera që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen mbulohen nga të ardhurat e realizuara nga veprimtaria kryesore.

Për vitin 2017, mbulimi i kostove O&M me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti në sektor është 113% nga 118% që ishte në vitin 2016 (sipas raportit të performancës 2016).

Kjo rënie ka ardhur, sepse kostot O&M janë rritur me 15% ndërkohë që të ardhurat nga shërbimet UK janë rritur vetëm me 10%.

Tabela 6. Zërat e kostove dhe të ardhurave krahasuar me vitin paraardhës

Emërtimi	Viti 2016 (në 000/lekë)	Viti 2017 (në 000/lekë)	Diferenca (në 000/lekë)
Kostot e punës	3,022,654	3,348,068	325,414
Energjia	2,319,503	2,523,851	204,349
Riparim dhe mirëmbajtje	447,020	643,331	196,311
Materiale e kimikate	144,723	151,808	7,085
Shpenzime shërbimesh financiare	399,311	446,316	47,006
Shërbimet e kontraktuara	359,655	599,933	240,278
Totali: kostot e O&M	6,611,119	7,570,877	959,758
Të ardhurat nga aktivitetit i shoqërive UK	7,786,551	8,543,918	757,367

Siç shihet nga tabela 6, rënia e treguesit të performancës së mbulimit të kostove O&M ka ardhur kryesisht nga rritja e numrit të punonjësve të shoqërisë, shërbimeve nga nënkontraktorët, konsumi i energjisë elektrike, si edhe i zërit të riparim-mirëmbajtjes.

Duke i parë shoqëritë në veçanti ka shumë shoqëri që kanë punuar mirë në drejtim të mbajtjes nën kontroll të kostove, por është dhe ekstremi tjetër, ku janë shumë shoqëri që mbulojnë kostot në nivele tejet të ulëta. Ato shoqëri e kanë të domosdoshme subvencionimin nga ana e qeverisë.

Në raportimet e bëra janë rreth 11 milionë lekë subvencione të dhëna shoqërive si subvencione operacionale, si dhe subvencione për diferencën (kosto-çmim).

Në detaje vlerësohet se 18 shoqëri mbulojnë kostot e Operim & Mirëmbajtje mbi 100%, (përfaqësojnë rreth 56% të popullsisë së shërbyer), 14 shoqëri i mbulojnë ato në vlerat 70-100% (22% e popullsisë së shërbyer), dhe 24 shoqëritë e tjera janë në nivele mjaft të ulëta të këtij treguesi, që përfaqësojnë 22 % të popullsisë së shërbyer (shih aneksin 6).

"Norma e arkëtimit" ka pësuar një rënie të konsiderueshme me 8% krahasuar me vitin 2016, gjë që lidhet me tendencën e moszbatimit të ligjit në periudhën elektorale. Një arsye tjetër e rënies së këtij treguesi është influenca që jep shtimi i zonës së shërbimit të shoqërive me pjesën kryesisht rurale të territorit të ri administrativ të bashkive që në përgjithësi karakterizohet me tregues të ulët arkëtimi.

Arkëtimet koherente janë 6,281 milionë lekë nga 7,490 milionë që faturohen (84%). Krahasuar me vitin 2016 arkëtimet koherente kanë qenë 6,449 milionë lekë dhe shitjet 7,049 milionë lekë (92%).

Fakti pozitiv është se gjatë vitit 2017 nga disa shoqëri janë arkëtuar në total rreth 1,146 milionë lekë debi të vjetra, gjë që tregon për mundësinë reale të mbledhjes së tyre me një angazhim më serioz të shoqërive.

"Uji pa të ardhura", si treguesi më i rëndësishëm i performancës, ka një përmirësim me rreth 2%, por mbetet akoma në vlera të papranueshme, që në vlera rezulton ngaqë uji i prodhuar ka pësuar një ulje me rreth 4.8 milionë m³ dhe ai i faturuar është rritur me rreth 4 milionë m³ ujë. Duke pasur gjithsesi rezervën në saktësinë e kësaj, të dhënë nga mungesa në mjaft raste e ujëmatësve të prodhimit në burim, ky përmirësim mund të jetë rrjedhojë e përmirësimit me rreth 4% të nivelit të matjes individuale të konsumatorëve.

Aktualisht prodhohet 341 litra ujë në ditë për frymë dhe faturohet 96 litra ose prodhimi mujor për një lidhje familjare është 38 m³ në muaj dhe faturimi është 10.6 m³ në muaj/lidhje.

Gjithsesi, reduktimi i humbjeve mbetet prioritet i punës së operatorëve dhe është në fokusin kryesor të reformës së sektorit që po zhvillohet. Nga elementet kryesore që parashikon reforma në këtë drejtim është legalizimi i lidhjeve të paligjshme dhe pajisja e tyre me matësa, instalimi për matjen e saktë të ujit të prodhuar në burim, si dhe forcimi i masave administrative e penale ndaj kundërvajtësve.

Për vlerësimin e saktë të vlerave të humbjeve administrative dhe teknike ERRU ka forcuar kërkesat ndaj shoqërive UK për të paraqitur një bilanc real të ujit në sistemet e tyre të furnizimit me ujë, si një element bazë edhe i planit të biznesit 5-vjeçar që shoqëritë duhet të hartojnë me planet përkatëse të veprimit për të realizuar zvogëlimin e "Ujit pa të ardhura".

"Niveli i matjes" është përmirësuar me 4%, si rezultat i investimeve në sektor. Në vlera numerike rezulton se nga 481,000 lidhje me matës në vitin 2016 raportohen 537,000 të tilla në vitin 2017, pra rreth 56,000 lidhje uji me matës që kanë ardhur kryesisht nga lidhjet e reja, por ka akoma 13,212 klientë jofamiljarë pa matës që bie në kundërshtim me VKM nr. 96, datë 21.02.2007.

Duke parë rëndësinë e këtij treguesi për administrimin e kërkesës për ujë, sektori duhet ta ketë si prioritet të investimeve instalimin e matësve për të gjithë konsumatorët.

"Eficienca e stafit" ka një përkeqësim të dukshëm në vitin 2017 me 1 person/1000 lidhje më shumë. Në vlerë absolute numri i punonjësve të punësuar nga vetë shoqëritë është rritur me

519 punonjës, gjë që nuk justifikohet me një rritje totale prej 119,000 të numrit të lidhjeve në vitin 2017 që kanë ardhur si rezultat edhe i shtimit të lidhjeve nga zona rurale pas reformës administrative territoriale. Efekti kryesor i këtij përkeqësimi ka ardhur sepse viti 2017 ka qenë vit elektorale dhe është i njohur fenomeni i punësimeve artificiale për efekte elektorale.

"Kohëzgjatja e furnizimit me ujë" si tregues ka mbetur pothuajse i pandryshuar (zvogëluar me 0.9 orë/ditë). Ky tregues varion nga një shoqëri në tjetrën nga 3-24 orë/ditë. Duke pasur parasysh vështirësitë në matjen dhe llogaritjen e tij, është i vështirë interpretimi i ecurisë së këtij treguesi.

Duhet theksuar fakti se nivelet e arritura të treguesve janë të lidhura me ndryshimet e ndodhura në sektorin UK. Situata aktuale nuk na lejon për një gjykim sa më real të performancës së sektorit, pasi shoqëritë UK janë duke kryer procedurat e riorganizimit, gjë e cila ka ndikuar edhe në raportimin e të dhënave e për rrjedhojë edhe në përlllogaritjen e treguesve. Nga ana tjetër, shoqëritë që kanë përfunduar riorganizimin në përputhje me reformën administrative territoriale treguesit e performancës nuk kanë bazë krahasimi për të kaluarën për zonën e re të shërbimit që ato mbulojnë.

2.2 Situata në zbatim të reformës në sektorin e ujit.

Reforma në sektorin e ujit i ka fillimet e saj me daljen e VKM nr. 63, në janar të vitit 2016, e cila presupozonte që riorganizimi i shoqërive UK sipas parimit 1 shoqëri = 1 bashki duhet të kishte përfunduar në fund të vitit 2016. Procesit i riorganizimit përfshinte inventarin fizik, vlerësimin dhe regjistrimin të njësive të shërbimit në strukturën e aseteve dhe kontabilitetin e shoqërive UK në pronësi të bashkisë dhe brenda 3 muajve nga përfundimi i tij shoqëritë duhet të aplikojnë pranë Entit Rregullator të Ujit për licencim dhe miratimin e tarifave. Në fakt, riorganizimi i shoqërive UK akoma nuk ka përfunduar, megjithëse ka kaluar edhe një vit tjetër mbas afatit të përcaktuar.

Riorganizimi i sektorit, në fakt, ishte një sfidë mjaft e madhe për shoqëritë dhe bashkitë për t'u realizuar në formën e kërkuar brenda afateve të përcaktuara në VKM.

Procesit të inventarizimit, vlerësimit dhe regjistrimit të aseteve, regjistrimi i tyre në QKB paraqet mjaft problematik, për shkak të mungesës së dokumentacionit për to, si dhe i dokumentacionit tjetër të nevojshëm për t'u regjistruar në QKB. Nga ana tjetër, marrja në dorëzim e zonave të reja rurale shoqërohet me përkeqësim të gjendjes financiare të shoqërive, për shkak të problemeve shtesë të mirëmbajtjes dhe të nevojës për investime të vogla.

Përfundimisht, deri në fund të viti 2017 janë licencuar nga ERRU 24 shoqëri UK nga rreth 60 që është totali i tyre, të cilat jepen në tabelën 7.

Tabela 7. Shoqëritë e riorganizuara dhe të licencuara sipas reformës

Nr.	Shoqëri të licencuara sipas reformës, viti 2016	Shoqëri të licencuara sipas reformës, viti 2017
1	Sh.a UK Kukës	Sh.a UK Gjirokastrë
2	Sh.a UK Kurbin	Sh.a U Gramsh
3	Sh.a UK Vorë	Sh.a UK Korçë
4	Sh.a UK Belsh	Sh.a UK Krujë
5	Sh.a UK Malësi e Madhe	Sh.a UK Mirditë
6		Sh.a U Poliçan
7		Sh.a UK Berat Kuçovë
8		Sh.a UK Devoll
9		Sh.a UK Maliq
10		Sh.a UK Patos
11		Sh.a UK Skrapar
12		Sh.a UK Vau Dejës
13		Sh.a UK Tepelenë
14		Sh.a UK Delvinë
15		Sh.a UK Lezhë
16		Sh.a UK Pogradec
17		Sh.a UK Shkodër
18		Sh.a UK Cërrik
19		Sh.a UK Roskovec

Edhe pse sipas VKM nr. 63, datë 27.01.2016, shoqëritë e riorganizuara duhet të aplikojnë brenda 3 muajve nga riorganizimi për licencim dhe miratimin e tarifës, vetëm 9 shoqëri ujësjellës kanalizime kanë aplikuar për miratimin e tarifave edhe për zonën e re të shërbimit gjatë vitit 2017.

Është për t'u theksuar fakti që jo të gjitha njësitet vendore dhe shoqëritë UK janë në kushte të njëjta në lidhje me problematikat e zbatimit të reformës. Shumica e bashkive dhe shoqërive UK, megjithëse me vonesë për shkak të problematikave të mësipërme, janë angazhuar seriozisht dhe kanë përmbushur detyrimet për përmbylljen e reformës.

ERRU në kuadër të reformës dhe qartësimit të përgjegjësisë sa i takon pronësisë dhe drejtimit të shoqërisë, ka zhvilluar mjaft takime me kryetarët e bashkive dhe administratorët e shoqërive në të gjithë vendin për të nxitur zbatimin sa më të shpejtë e të drejtë të reformës në sektorin e ujit, duke ofruar edhe asistencë në lidhje me mënyrat dhe procedurat që duhen ndjekur për një realizim me sukses të procesit të inventarizimit të aseteve.

Procesi i reformës, i nisur në janar 2016, paraqitej i cunguar dhe jo i zbatuar me angazhimin e duhur të të gjithë aktorëve në sektor. Nga ana tjetër, dokumentacioni ligjor që lidhej me përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë nuk ishte konkret (kontratat e performancës), si dhe reforma nuk shoqërohej me plane e veprime të qarta dhe konkrete. Rrjedhimisht, rezultatet pozitive që priteshin prej saj nuk u realizuan.

Në muajin tetor 2017, kryeministri lançoi reformën në sektorin e ujësjellës kanalizimeve. Domosdoshmëria e reformës argumentohet duke pasur parasysh gjendjen e rënduar nga ana financiare dhe e cilësisë së shërbimeve që ofron sektori i UK, siç jepet edhe nga treguesit kryesorë të performancës, të analizuara. Reforma analizoi dhe mori parasysh karakteristikat reale të sektorit të ujit, si më poshtë:

- Sistemi i administrimit të sektorit është i decentralizuar me përgjegjësi direkte nga pushteti vendor.
- Sektori është mjaft i fragmentarizuar (58 shoqëri) dhe i pabalancuar financiarisht me borxhe të konsiderueshme, ku vetëm 19 shoqëri mbulojnë shpenzimet e O&M.
- Shoqëritë e vogla dhe të mesme nuk kanë mundësi financiare qoftë edhe për investime të vogla.
- Mungesë përgjegjësie nga pushteti vendor dhe stafi drejtues i shoqërive të UK, ngaqë deficitin në bilanci financiar të shoqërive kompensohen nga Qeveria Qendrore me subvencione.
- Cilësi e ulët shërbimi me furnizim me ujë mesatarisht 12/24 orë në ditë (vetëm shoqëritë e UK Korçë, UK Pogradec dhe UK Librazhd ofrojnë shërbim të vazhdueshëm 24 orë në ditë).
- Mjaft asete janë të amortizuara, pra sektori ka nevojë për investime fizike.
- Sistemi nuk është i pajisur 100% me matësa.
- Tarifat e shërbimit janë të ndryshme (jo të unifikuara) dhe relativisht të ulëta (nën nivelin e 5% të të ardhurave mesatare për familje).
- Sektori operon me humbje të konsiderueshme (67%) teknike dhe administrative. Humbjet administrative janë kryesisht nga lidhjet e paligjshme (rreth 20%), nënfaturimi i lidhjeve aforfe (pa matës), by-pass i matësit, korrupsioni i faturuesve.
- Prani e konsiderueshme e debive të këqija dhe të prapambetura.
- Normë arkëtimi e lartë (92%).
- Sektori është i mbingarkuar me staf.

Në thelb sektori i ujësjellës kanalizimeve ka si mangësi kryesore në performancën e tij:

- a) mungesën e përgjegjësisë dhe kontroll-monitorimit nga organet mbikëqyrëse mbi shoqëritë, në veçanti mbi drejtorët ekzekutivë për aspektet e menaxhimit dhe të performancës,
- b) mungesën e investimeve fizike të mjaftueshme në sektor.
- c) Megjithatë fatura është titull ekzekutiv, zbatimi mjaft i dobët i legjislacionit për klientët me lidhje të jashtëligjshme, debitorëve, si dhe ndaj stafit abuzues të shoqërive me detyrën.

Për shëndoshjen e gjendjes së sektorit reforma konsiston në këto elemente:

- eliminimin e lidhjeve të paligjshme që vlerësohen të jenë në rreth 20% të abonentëve,
- zbatimin e ligjshmërisë për kundërvajtësit dhe abuzuesit,

- pajisjen 100% të konsumatorëve me matës uji,
- rritjen e normës së arkëtimit, përfshirë dhe debitë e trashëguara.
- shpërndarjen e investimeve bazuar në performancë.
- agregimi i sektorit.

Eliminimi i lidhjeve të paligjshme do të ketë një fazë mirëkuptimi dhe vullnetarizmi në deklarin dhe legalizimin e tyre (deri më 1 shkurt 2018) që do të ndihet më tej nga faza (mbas 1 shkurtit) që do të fillojë zbatimin i ligjit duke e konsideruar praninë e lidhjeve të paligjshme si vepër penale.

Reforma parashikon gjithashtu që të subvencionohen shtresat në nevojë, si dhe disa kategori të tjera të veçanta, si invalidët e ndryshëm etj., të cilëve do t'u instalohet falas ujëmatësi, si dhe do të furnizohen me ujë falas për një sasi prej 20 litra/ditë/banor.

Në përgjithësi reforma presupozon që shoqëritë UK të mos subvencionohen nga Qeveria Qendrore, si dhe të favorizohen nga kjo e fundit me investime në rastin e një performancë të mirë të tyre. Investimet duhet të jenë të mirëargumentuara nga ana tekniko-ekonomike, si dhe të mbështetura nga një plan biznesi 5-vjeçar.

Nga përshkrimi i gjendjes së sektorit më sipër vihet re relativisht një përqindje e lartë e mbledhjes së faturave, ndërkohë që përgjithësisht sektori është në gjendje jo të mirë financiare. Kjo tregon që krahas problemit të lidhjeve të paligjshme, faktor tjetër kryesor për gjendjen e dobët financiare janë edhe tarifat e ulëta të shërbimeve, që siç u trajtua më sipër (përballueshmëria) kanë mjaft hapësirë për rritjen e tyre. Këtë fakt ERRU e ka një ndër konsideratat kryesore gjatë analizës, vlerësimit dhe miratimit të tarifave që propozojnë shoqëritë UK.

Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime mbulohen nga rreth 60 shoqëri UK, nga të cilat vetëm 2 shoqëri të bashkive Tiranë dhe Durrës mbulojnë rreth gjysmën e popullsisë efektive të vendit. Një sektor mjaft i fragmentarizuar si i yni me rreth 60 shoqëri UK vuan nga mungesa e ekonomisë së shkallës dhe operon me kosto mjaft të larta.

Si pjesë e reformës paraqitet e nevojshme që në fazën post-emergjente zvogëlimi i numrit të shoqërive UK, gjë e cila do të sjellë përmirësime të performancës së sektorit, si nga rritja e ekonomisë së shkallës edhe nga kapacitetet e stafeve kyçe manaxhuese të shoqërive UK.

Nga ana tjetër, përmirësimi i performancës së sektorit lidhet ngushtësisht me sigurimin e fondeve për investime fizike. Në strategjinë kombëtare të financimit të sektorit të ujësjellës kanalizimeve nevojat për investime vlerësohen të jenë rreth 170 milionë euro/vit në shtrirjen e 22 viteve dhe nga buxheti i shtetit dhe donatorët mund të përballohet rreth 50% e nevojave për investime në sektor.

Së shpejti pritet që vendi ynë të hapë negociatat për pranimin në Bashkimin Europian. Me hapjen e negociatave pritet që Bashkimi Europian të alokojë fonde të konsiderueshme për sektorin e ujit në përmbushje të standardeve të direktivës së ujit të KE.

Një sektor i fragmentarizuar ka kapacitete mjaft të kufizuara për përthithjen e këtyre fondeve. Nga eksperiencia e mëparshme të vendeve pas hapjes së negociatave për në BE, si Bullgaria dhe Rumania, përthithja e këtyre fondeve nga një sektor i fragmentarizuar bëhej me

vështirësi, dhe në fund veprat e ndërtuara prej tyre rezultuan me kosto operimi dhe mirëmbajtje (O&M) të pajustificueshme nga ana ekonomike.

Agregimi i shoqërive UK, si shprehje tipike e avantazhit të ekonomisë së shkallës, propozohet si zgjidhje dhe instrument i domosdoshëm që bën të mundur jo vetëm përthithjen më të shpejtë në sasi të këtyre fondeve, por më tej, veprat e realizuara prej tyre kanë kosto O&M ekonomikisht efikase.

Realisht në vendin tonë gjatë gjithë fazës së tranzicionit nuk është realizuar asnjë agregim real i suksesshëm i shoqërive UK. Agregimi në vetvete është një proces kompleks e delikat, ku ndërthuren mjaft faktorë objektivë dhe subjektivë, por në themel të realizimit të suksesshëm të tij qëndron konkluzioni i studimit të bëshmërisë për agregimin e sektorit të ujësjellës kanalizimeve në vendin tonë që agregimi duhet realizuar në baza vullnetare dhe me iniciativa nga Qeveria Qendrore.

Përsa më sipër propozohet që për t'i paraprirë një strategjie agregimi të sektorit për një periudhë afatmesme, që paralelisht me reformën të realizohet një shembull pilot agregimi i suksesshëm i dy ose më shumë shoqërive UK në sektor, që do të shërbejë si shembull bëshmërie i realizimit të strategjisë së sektorit për t'u zhvilluar në shkallë të gjerë në periudhën afatmesme. Për këtë duhet të financohet një studim bëshmërie për rastin pilot të agregimit që do të marrë parasysh angazhimin vullnetar për realizimin e tij nga dy ose më shumë njësi vendore, dhe që do të mbështetet me incentiva (financime) me investime fizike nga qeveria qendrore nga buxheti ose donatorët.

3. Rekomandime për përmirësimin e performancës së ERRU-së dhe për sektorin e ujit

Referuar problematikës dhe vështirësive që ERRU ka hasur gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj në sektorin e ujit, më poshtë jepen disa rekomandime për hartimin e disa ndryshimeve në ligjin nr. 8102, i ndryshuar, që konsiderohen të nevojshme për forcimin e rolit të ERRU-së si institucion i pavarur, përkatësisht:

- ERRU të jetë pala monitoruese, përcaktuese dhe vlerësuese e treguesve të performancës së kontratave që do të lidhen në kuadër të reformës për ujin ndërmjet AKUK dhe bashkive;
- Saktësimi dhe ndarja e përgjegjësi dhe të drejtave midis ERRU-së dhe AKUK që aktualisht janë konfuze dhe me mbivendosje;
- Për të luajtur plotësisht rolin si monitorues i shoqërive UK dhe të sektorit të ujit duke përfshirë në strukturën e tij Njësinë e Monitorim Benchmark që aktualisht ndodhet pranë AKUK;
- Ngritjen institucionalisht të Këshillit Teknik pranë AKUK për vlerësimin tekniko-ekonomik të të gjitha projekteve të propozuara në fushën e ujësjellës kanalizimeve me përfaqësues edhe nga ERRU;
- Propozim për rishikimin e VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", me rekomandime konkrete në funksion të kërkesave të situatës aktuale të reformës së sektorit;
- Për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarit të KKRR jo nga Këshilli i Ministrave, por nga Kuvendi i Shqipërisë, si dhe të kohëzgjatjes së mandatit nga 4 në 5-vjeçar, përfshirë dhe kriteret që ato duhet të përmbushin;
- Për një përmirësim në menaxhimin e kapaciteteve njerëzore dhe atij financiar të buxhetit të ERRU-së për rritjen e kapaciteteve dhe efikasitetit të punës së tij;

4. Objektivat e punës së ERRU-së dhe sektorit të ujit për vitin 2018

- *Rishikimi i "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura", miratuar me vendim të KKRR nr. 42, datë 09.12.2015.*

Metodologjia aktuale e llogaritjes së tarifave ka nevojë të përmirësohet në përputhje me kërkesat e reformës në sektor, si dhe të kërkesave për një menaxhim bashkëkohor të sektorit të ujësjellës kanalizimeve. Metodologjia e përmirësuar do të ketë si bazë vlerësimi performancën tekniko-ekonomike të shoqërive dhe objektivat për përmirësimin e tyre në përputhje me planin e biznesit 5-vjeçar të shoqërisë. Duke pasur parasysh që metodologjia duhet të marrë parasysh jo vetëm rastin kur shoqëritë nuk mbulojnë shpenzimet e O&M, por edhe ato të mbulimit të nevojave

për investime, metodologjia duhet të përfshijë elemente dhe argumente më të detajuara në lidhje me justifikimin e kërkesës për investime që duhet të mbulohen me tarifat e propozuara.

- *Marrjen e iniciativës për rishikimin e kodit të furnizimit me ujë dhe kanalizime, aprovuar me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, si model i rregullores "Për furnizimin me ujë dhe kanalizime në zonën e shërbimit të shoqërisë anonime ujësjellës kanalizime".* Nga eksperiencia e deritanishme konstatohet që kodi ka nevojë për përmirësime dhe shtesa të detajeve të ndryshme në të dyja fushat, përkatësisht atë të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, kryesisht në detyrimet dhe të drejtat në marrëdhëniet shoqëri-konsumator.
- *Rishikimi i ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar.* Për këtë qëllim, në vitin 2016 është ngritur një grup pune në MIE, por që prej një viti nuk po vazhdon aktivitetin për hartimin e draftit të rishikuar të këtij ligji. Rishikimi i ligjit konsiderohet akoma më i nevojshëm në kuadrin e reformës së sektorit të ujit, ku kërkohet një forcim i rolit të ERRU-së si promotor për ngritjen dhe përmirësimin e performancës së sektorit të ujit. Fokusi kryesor i rishikimeve të ligjit të mësipërm do të jetë forcimi i rolit të ERRU-së si ent i pavarur nga ana institucionale dhe financiare, si dhe përcaktimi i një ndarjeje më të qartë të rolit e të drejtave ndërmjet ERRU-së dhe AKUK.
- *Rishikimi i rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të entit rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", aprovuar me vendim të KKRR, me datë 02.12.2016.* Rishikimi i ligjit për kuadrin rregullator shoqërohet domosdoshmërisht edhe me nevojën për rishikim të rregullores së brendshme të ERRU-së.
- *Në bashkëpunim me Inspektoratin Sanitar Shtetëror, t'u propozohen ministrive përkatëse të linjës që të bëhen ndryshime në ligjin nr. 7643, datë 02.12.1992, "Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror, i ndryshuar, si dhe rishikim të udhëzimit të ministrit të Shëndetësisë nr. 510, datë 13.12.2011 "Për inspektimet higjeno-sanitare në funksion të lëshimit të akt-miratimit higjeno-sanitar".* Rishikimi konsiderohet i nevojshëm për standardizimin e akt-miratimit higjeno-sanitar që lëshohet nga degët rajonale të ISSH për sistemet e furnizimit me ujë në zonat e shërbimit të shoqërive ujësjellës kanalizime, si dhe forcimin e kërkesave në zbatim të detyrimeve ligjore nga këto të fundit për përmbushjen e kushteve për pajisjen me akt-miratimin higjeno-sanitar.
- *Hartimi dhe botimi i raportit të performancës së shoqërive ujësjellës kanalizime për vitin 2017 jo më vonë se mesi i korrikut 2018.* Deri në vitin 2016 hartimi i raportit të performancës së sektorit ka qenë realizuar jo më parë se fundi i tetorit i vitit pasardhës. Në vitin 2017 raporti performancës së shoqërive UK 2016 u arrit të realizohej në mesin e muajit korrik 2017, që ishte dhe objektivi i vendosur më parë nga ERRU. Duke parë rëndësinë e realizimit të këtij raporti në kohë për zbatimin e rekomandimeve që jepen për përmirësimin e

performancës së sektorit, si dhe impenjimin që kërkon për ta realizuar atë në këtë afat, ai mbetet në vazhdimësi si objektiv për t'u arritur nga stafi dhe komisioni i ERRU.

- *Të luajë një rol nxitës dhe ndërgjegjësues që paralelisht me reformën të fillojë realizimi i një shembulli pilot agregimi i suksesshëm i dy ose më shumë shoqërive UK në sektor.* Një sektor mjaft i fragmentarizuar si i yni me rreth 60 shoqëri UK vuan nga mungesa e ekonomisë së shkallës dhe operon me kosto mjaft të larta. Së shpejti pritët që vendi ynë të hapë negociatat për pranimin në Bashkimin Europian. Me hapjen e negociatave pritët që Bashkimi Europian të alokojë fonde të konsiderueshme për sektorin e ujit në përmbushje të standardeve të direktivës së ujit të KE.

Një sektor i fragmentarizuar ka kapacitete mjaft të kufizuara për përthithjen e këtyre fondeve. Nga eksperiencia e mëparshme të vendeve pas hapjes së negociatave për në BE, si Bullgaria dhe Rumania, përthithja e këtyre fondeve nga një sektor i fragmentarizuar bëhet me vështirësi, dhe në fund veprat e ndërtuara prej tyre rezultuan me kosto operimi dhe mirëmbajtje (O&M) të pajustificueshme nga ana ekonomike. Për këtë kërkohet që të financohet një studim bëshëmërie për rastin pilot të agregimit që do të marrë parasysh angazhimin vullnetar për realizimin e tij nga dy ose më shumë njësi vendore, dhe që do të mbështetet me incentiva (financime) me investime fizike nga qeveria qendrore nga buxheti ose donatorët.

- *Propozim për rishikimin e VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", me rekomandime konkrete në funksion të kërkesave të situatës aktuale të reformës së sektorit.*

VKM nr. 63 aktualisht përbën dokumentin ligjor bazë në zbatimin e reformës së sektorit të ujit pas reformës administrative territoriale. Në aspektin praktik ai është i paplotë për një zbatim efikas të reformës, dhe në disa raste paraqet kontradiksione ligjore të hierarkisë, nga ku lind domosdoshmëria e rishikimit të tij në funksion të situatës aktuale.

- *Hartimi dhe miratimi i një rregulloreje të trajtimit të ankesave të konsumatorëve brenda vitit 2018.*

Kjo rregullore do të përcaktojë qartësisht kushtet dhe procedurat për shqyrtimin dhe zgjidhjen e tyre. ERRU ka rolin e ndërmjetësuesit në trajtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis ankesave të konsumatorëve dhe të licencuarve, por kjo rregullore shihet si një akt i domosdoshëm në mbështetje për një zgjidhje sa më të drejtë dhe efikase të ankesave të konsumatorëve.

Aneksi 1. Rekomandimet që Kuvendi ka miratuar në rezolutën e tij për ERRU-në për vitin 2017.

Për vitin 2017 Kuvendi ka rekomanduar:

- 1.** Të marrë masat e nevojshme për përballimin në kohë dhe me cilësi të shqyrtimit të propozimeve nga shoqëritë UK për rishikimin e tarifave, në kuadër të zbatimit të VKM nr. 63, datë 27.1.2016, si dhe të tregohet efikase dhe e kujdesshme në politikën e miratimit të tarifave, duke e parë atë të lidhur ngushtë me rritjen e performancës së operatorëve, uljes së shpenzimeve, rritjen e efikasitetit menaxhues dhe përmirësimin e shërbimit ndaj konsumatorit.
- 2.** Të marrë masat e nevojshme për licencimin, brenda vitit 2017, të të gjithë operatorëve UK që paraqiten pranë ERRU-së për licencim, në kuadër të përfundimit të procesit të riorganizimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime, në zbatim të VKM nr. 63, datë 27.1.2016, si dhe monitorimin e kushteve të licencës.
- 3.** Të vijojë të nxisë të gjitha shoqëritë që të vazhdojnë me procesin e inventarizimit, në zbatim të ristrukturimit të sektorit UK, në kuadër të reformës territoriale, për të vijuar më tej me licencimin dhe miratimin e tarifave, në përmbushje dhe të kërkesave ligjore.
- 4.** Të vijojë përpjekjet në mbrojtje të konsumatorëve dhe zgjidhjes së ankesave të tyre, pavarësisht rolit ndërmjetës që ka me dispozitat në fuqi dhe vonesës së ndryshimeve të pritshme ligjore.
- 5.** Të thellojë bashkëpunimin me të gjithë aktorët për të bërë një vlerësim sa më real dhe objektiv të përballueshmërisë së tarifave dhe për të gjetur zgjidhjen më të mirë të mundshme për mbrojtjen e konsumatorëve me të ardhura të ulëta dhe njëkohësisht funksionimin e operatorëve në mënyrë të qëndrueshme.
- 6.** Të vijojë kontributin e saj për hartimin sa më parë të ligjit të ri, në përputhje me objektivat e strategjisë kombëtare të furnizimit me ujë dhe kanalizime dhe direktivat e BE-së për institucionet e pavarura, ligj, i cili, ndër të tjera, synon rritjen e rolit të ERRU-së në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit, veçanërisht në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si dhe rritjen e pavarësisë së institucionit të ERRU-së.
- 7.** Të marrë masat e nevojshme për implementimin e strukturës së re të ERRU-së, miratuar me vendim të Kuvendit nr. 34, datë 28.4.2016, duke e parë të lidhur ngushtë me rritjen e profesionalizmit dhe të pavarësisë operationale të rregullatorit, si dhe në përmbushje të sfidave që ERRU-ja ka përballë reformës territoriale.
- 8.** Përmes të gjitha instrumenteve ligjore që disponon, të kërkojë nga shoqëritë UK që të kenë përparësi të punës së tyre uljen e nivelit të humbjeve, i cili vijon të mbetet 67 për qind, nivel i cili është tepër i lartë dhe përbën një shqetësim kryesor për sektorin UK; evidentimi, eliminimi apo legalizimi i lidhjeve të paligjshme, me qëllim uljen e humbjeve në rrjet dhe uljen e ujit pa të ardhura, ndikojnë drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK.

9. Të vijojë nxitjen e shoqërive UK në instalimin e ujëmatësve të mëdhenj në të gjitha pikat kyçe të sistemeve të furnizimit me ujë, për të bërë të mundur hartimin e bilanceve të sakta të ujit, të cilat japin mundësinë e përcaktimit real të vlerës së “Ujit pa të ardhura” (humbjet administrative dhe teknike), si dhe përcaktimin e rrugëve dhe planeve të veprimit për zvogëlimin e tyre.
10. Të vijojë nxitjen dhe monitorimin e vendosjes së matësve për konsumatorët nga shoqëritë UK, si një proces plotësisht i arritshëm nga shoqëritë UK, i cili do të ndikonte drejtpërdrejt në uljen e nivelit të lartë të faturimit aforfe për konsumatorët, si dhe në uljen e nivelit të shpërdorimit të ujit.
11. Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve, përmes instrumenteve dhe strategjive rregulluese, të nxisë shoqëritë UK në rritjen e vazhdimësisë së shërbimit dhe cilësinë e ujit të pijshëm. Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm dhe tendenca negative e këtij treguesi vijon të mbetet problem shqetësues, duke ndikuar edhe në cilësinë e ujit.
12. Duke pasur parasysh që analiza e humbjeve, bazuar në “Bilancin e ujit”, tregon që humbjet menaxheriale të ujit janë në nivele pothuajse të njëjta me ato teknike, nëpërmjet instrumenteve dhe strategjive rregulluese të kërkojë nga shoqëritë UK një menaxhim më të mirë të shërbimit të furnizimit me ujë.
13. Të vendosë objektiva individuale për secilën nga shoqëritë ujësjellës kanalizime, për të nxitur përmirësimin e mëtejshëm të efikasitetit operacionale dhe gjatë procesit të miratimit të tarifave të kërkojë nga shoqëritë argumentim të plotë mbi numrin e punonjësve dhe pozicionet e tyre të punës në strukturën organizative të shoqërisë.
14. Të vijojë punën për monitorimin e rezultateve, nëpërmjet verifikimit të të dhënave në veçanti të të dhënave që lidhen me treguesit kryesorë të performancës, pasi saktësia e të dhënave luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e tarifave.
15. Të marrë masat e nevojshme dhe, në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, të përgatisë aktet nënligjore, në mënyrë që shoqëritë UK të hartojnë planin e biznesit 5-vjeçar, si një instrument i domosdoshëm i aplikimit për tarifa të reja, dhe, në të njëjtën kohë, si një instrument vlerësimi nga ERRU-ja.
16. Në bashkëpunim me AKUK-un (Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve) të krijojë një sistem dixhital qendror raportimi, me të dhëna që raportohen *online* nga shoqëritë e UK, dhe këto të dhëna të jenë disponibël në *web*.
17. Të intensifikojë kontaktet me bashkitë, shoqëritë UK, si dhe bashkëpunimin me AKUK-un dhe gjithë aktorët në sektor për identifikimin e pengesave në realizimin e reformës në sektor, për të bërë të mundur kapërcimin e tyre dhe ecjen graduale drejt një sektori ujësjellës kanalizimesh të pavarur financiarisht, që mbulon shpenzimet dhe ofron shërbime me cilësi të mirë dhe të përballueshme nga konsumatorët.
18. Të jetë një pjesëmarrës aktiv dhe të japë kontribut konkret në përmirësimin e infrastrukturës ligjore në drejtim të përmbushjes së kushteve të Direktivës Europiane për Sektorin e Ujit.

Aneksi 2. Aplikimet e shoqërive dhe situata e licencimit për vitin 2017

Tabela 1. Aplikimet e shoqërive që kanë kaluar për vendimmarrje

Nr	Shoqëritë që kanë aplikuar	Kanë kaluar për vendimmarrje në KKRR					
		Mbarim afati	Ndryshim Drejtuesi ligjor	Ndryshim Drejtuesi teknik	Shtim kategorie	Ndryshim zone shërbimi	Shoqëri të reja
1	Sh.a.UK Belsh	Sh.a.UK Berat - Kuçovë	Sh.a.UK Belsh	Sh.a.UK Gjirokastrë	Sh.a.UK Patos	Sh.a.UK Gjirokastrë	Sh.a.UK Cërrik
2	Sh.a.UK Berat - Kuçovë	Sh.a.UK Devoll	Sh.a.UK Elbasan (Q)	Sh.a.UK Maliq	Sh.a.UK Skrapar	Sh.a.U Gramsh	Sh.a.UK Roskovec
3	Sh.a.UK Devoll	Sh.a.UK Delvinë	Sh.a.UK Elbasan (Q)	Sh.a.UK Patos		Sh.a.UK Korçë (Q)	
4	Sh.a.UK Cërrik	Sh.a.UK Durrës	Sh.a.UK Gjirokastrë	Sh.a.UK Pogradec		Sh.a.UK Krujë	
5	Sh.a.UK Delvinë	Sh.a.UK Gjirokastrë	Sh.a.U Malësi e Madhe			Sh.a.UK Mirditë	
6	Sh.a.UK Durrës	Sh.a.UK Kolonë	Sh.a.UK Pogradec			Sh.a.U Poličan	
7	Sh.a.UK Elbasan (Q)	Sh.a.UK Korçë (Q)				Sh.a.UK Berat - Kuçovë	
8	Sh.a.UK Elbasan (Q)	Sh.a.UK Krujë				Sh.a.UK Devoll	
9	Sh.a.UK Gjirokastrë	Sh.a.UK Lezhë				Sh.a.UK Maliq	
10	Sh.a.U Gramsh	Sh.a.UK Librazhd				Sh.a.UK Patos	
11	Sh.a.UK Kolonjë	Sh.a.UK Maliq				Sh.a.UK Skrapar	
12	Sh.a.UK Korçë (Q)	Sh.a.UK Mat				Sh.a.UK Vau i Dejës	
13	Sh.a.UK Krujë	Sh.a.UK Mirditë				Sh.a.UK Tepelenë	
14	Sh.a.UK Lezhë	Sh.a.UK Patos				Sh.a.UK Delvinë	
15	Sh.a.UK Librazhd	Sh.a.UK Pogradec				Sh.a.UK Lezhë	
16	Sh.a.U Malësi e Madhe	Sh.a.U Poličan				Sh.a.UK Pogradec	
17	Sh.a.UK Maliq	Sh.a.UK Skrapar				Sh.a.UK Shkodër	
18	Sh.a.UK Maliq	Sh.a.UK Tepelenë					
19	Sh.a.UK Mat	Sh.a.UK Tiranë					
20	Sh.a.UK Mirditë	Sh.a.UK Vau i Dejës					
21	Sh.a.UK Patos	Sh.a.UK Vlorë					
22	Sh.a.UK Pogradec	Sh.a.UK Shkodër					
23	Sh.a.U Poličan						
24	Sh.a.U Poličan						
25	Sh.a.UK Roskovec						
26	Sh.a.UK Skrapar						
27	Sh.a.UK Tepelenë						
28	Sh.a.UK Vau i Dejës						
29	Sh.a.UK Vlorë						
30	Sh.a.UK Tiranë						
31	Sh.a.UK Shkodër						
32	Sh.a.UK Tiranë						
33	Sh.a.UK Peshkopi Kategoria C						
34	Sh.a.UK Himarë						
35	Sh.a.UK Përmet						
36	Sh.a.U Këlcyrë						
37	Sh.a.UK Libohovë						
38	Sh.a.UK Rrogozhinë						
39	Sh.a.UK Sarandë						
40	Sh.a.UK Fushë Arrëz						
41	Sh.a.U Selenicë						
42	Sh.a.UK Mallakastër						
43	Sh.a.U Pustec						



Dymbëdhjetë (12) operatorë UK që janë në proces të rinovimit të licencës

Tabela 2. *Situata e gjendjes së licencimit të shoqërive UK*

Nr.	Me licencë të vlefshme	Në proces rinovimi	Pa licencë
		Mbarim afati, ndryshim drejtuesi ligjor/teknik, ndryshim zone shërbimi	
1	Sh.a. U Bulqizë	Sh.a. UK Himarë	Sh.a. U Këlcyrë
2	Sh.a. UK Gjirokastrë	Sh.a. U Selenicë	Sh.a. UK Mallakastër
3	Sh.a. U Orikum	Sh.a. UK Sarandë	Sh.a. UK Fushë Arrëz
4	Sh.a. UK Elbasan	Sh.a. U Tropojë	Sh.a. UK Peqin
5	Sh.a. UK Fier	Sh.a. UK Peshkopi kategoria A	Sh.a. U Novoselë
6	Sh.a. UK Devoll	Sh.a. UK Rrogozhinë	Sh.a. U Has
7	Sh.a. UK Lushnjë	Sh.a. U Përmet	Sh.a. UK Krastë
8	Sh.a. UK Lezhë	Sh.a. U Elbasan Fshat	Sh.a. UK Kamzë
9	Sh.a. UK Tepelenë	Sh.a. UK Libohovë	
10	Sh.a. UK Peshkopi kategoria C	Sh.a. UK Kavajë	
11	Sh.a. UK Korçë	Ndërmarrje U Divjakë	
12	Sh.a. UK Durrës	Sh.a. UK Fier	
13	Sh.a. UK Mat	Sh.a. UK Pustec	
14	Sh.a. UK Delvinë		
15	Sh.a. UK Berat - Kuçovë		
16	Sh.a. UK Patos		
17	Sh.a. UK Tiranë		
18	Sh.a. U Kurbin		
19	Sh.a. U Ura Vajguore		
20	Sh.a. UK Librazhd		
21	Sh.a. U Gramsh		
22	Sh.a. U Malësi e Madhe		
23	Sh.a. UK Kukës		
24	Sh.a. UK Vorë		
25	Sh.a. UK Kolonjë		
26	Sh.a. UK Pogradec		
27	Sh.a. UK Krujë		
28	Sh.a. U Poliçan		
29	Sh.a. UK Vau i Dejës		
30	Sh.a. UK Bashkia Pukë		
31	Sh.a. UK Belsh		
32	Sh.a. UK Maliq		
33	Sh.a. UK Cërrik		
34	Sh.a. UK Vlorë		
35	Sh.a. UK Skrapar		
36	Sh.a. UK Mirditë		
37	Sh.a. UK Roskovec		
38	Sh.a. UK Shkodër		

Aneksi 3. Aplikimet për ndryshimin e tarifave në vitin 2017

Operatori		Shërbimi	Kategoritë e klientëve	Tarifat aktuale para propozimit për ndryshim		Tarifat sipas propozimit të operatorit		Tarifat sipas vendimit të KKRR	
				lekë/klientë/ muaj	lek/m3	lekë/klientë/ muaj	lek/m3	lekë/klientë/ muaj	lek/m3
				fikse	variabël	fikse	variabël	fikse	variabël
Sh.a UK Tiranë		ujë i pijshëm	Klientë familjarë	100	45	200	65	200	65
			Klientë publikë	100	120	200	170	200	140
			Klientë privat	100	135	200	190	200	155
			Klientë të veçantë	100	170	200	235	200	170
			Klientë Furra buke	100	95	200	130	200	95
		ujë i ndotur	Shitje uji me shumicë		12		15		12
			Hec Lanabregas		5		6		5
			Klientë familjarë		11		11		11
			Klientë publikë		30		30		30
			Klientë privat		35		35		35
Sh.a UK Ura Vajgurore		ujë i pijshëm	Klientë të veçantë		40		40		40
			Klientë Furra buke		13		13		13
Sh.a UK Korçë ekzistuese		ujë i pijshëm	Shitje e Ujit me shumicë				29		29
			Klientë familjarë	120	65	140	72	140	72
			Klientë publikë	120	110	140	117	140	117
		ujë i ndotur	Klientë privat	120	140	140	140	140	140
			Klientë familjarë		34		42		42
			Klientë publikë		56		64		64
Sh.a UK Korçë zonat e reja		ujë i pijshëm	Klientë privat		56		64		64
			Klientë familjarë		30/20/15/10	100	38/28/28/28	100/100/100/100	38/28/28/28
			Klientë publikë		110/110/110/110	100	110/110/110/110	100/100/100/100	110/110/110/110
Sh.a UK Berat-Kuçovë zonat e reja		ujë i pijshëm	Klientë privat		60/60/60/60	100	100/100/100/100	100/100/100/100	100/100/100/100
			Klientë familjarë	100	50	100	50	100	50
			Klientë publikë	200	150	200	150	200	150
		ujë i ndotur	Klientë privat	200	150	200	150	200	150
			Shitje e ujit me shumicë				5.4		5.4
			Klientë familjarë		14.4		14		14
		ujë i ndotur	Klientë publikë		24		24		24
			Klientë privat		24		24		24
		ujë i ndotur	Klientë familjarë	100	50	100	40	100	40
			Klientë publikë	200	150	200	150	200	150
			Klientë privat	200	150	200	150	200	150
		ujë i ndotur	Shitje e ujit me shumicë		shërbim I ri		5.4		5.4
			Klientë familjarë		14.4		14		14
			Klientë publikë		24		24		24
			Klientë privat		24		24		24
Sh.a U Malësi e Madhe		ujë i pijshëm	Klientë familjarë		50		50	në proces	
			Klientë publikë		120		120		
			Klientë privat		120		120		
			Shitje e Ujit me shumicë				10		
Sh.a UK Shkodër		ujë i pijshëm	Klientë familjarë	100	40	200	50	në proces	
			Klientë publikë	100	110	200	120		
			Klientë privat	100	110	200	120		
		ujë i ndotur	Klientë familjarë		15		20		
			Klientë publikë		20		25		
			Klientë privat		20		25		
Sh.a UK Maliq		ujë i pijshëm	Klientë familjarë	50	38	54	45	në proces	
			Klientë publikë	50	90	54	100		
			Klientë privat	50	95	54	105		
		ujë i ndotur	Klientë familjarë		pa shërbim		50		
			Klientë publikë		pa shërbim		50		
			Klientë privat		pa shërbim		50		
Sh.a UK Fier		ujë i pijshëm	Klientë familjarë	200/200/200/0/0/0/0/0/0	45/52/52/50/42/50/45/45/40	200	52	në proces	
			Klientë publikë	200/200/200/0/0/0/0/0/0	105	200	105		
			Klientë privat	200/200/200/0/0/0/0/0/0	125/125/125/50/125/60/125/0	200	125		
		ujë i ndotur	Klientë familjarë	0	13/13/13/0/13/0/0/0	0	13		
			Klientë publikë	0	18	0	18		
			Klientë privat	0	20/20/20/0/0/0/0/0/0	0	20		
Sh.a U Gramsh		ujë i pijshëm	Klientë familjarë		pa shërbim	60	32	në proces	
			Klientë publikë		pa shërbim	180	90		
			Klientë privat		pa shërbim	150	90		
Sh.a UK Skrapar		ujë i pijshëm	Klientë familjarë		27	100	35	në proces	
			Klientë publikë		80	100	100		
			Klientë privat		95	100	110		
		ujë i ndotur	Klientë familjarë		pa shërbim		10		
			Klientë publikë		pa shërbim		10		
			Klientë privat		pa shërbim		10		
Sh.a UK Krujë zonat e reja		ujë i pijshëm	Klientë familjarë		33/28		35	në proces	
			Klientë publikë		80/60		100		
			Klientë privat		80/80		120		
		ujë i ndotur	Klientë familjarë		8/6		8		
			Klientë publikë		12/10		12		
			Klientë privat		12/12		12		

Aneksi 4. Shoqëri që kanë aplikuar në vitin 2016 dhe janë miratuar në 2017

Operatori	Shërbimi	Kategoritë e klienteve	Tarifat aktuale para propozimit për ndryshim		Tarifat sipas propozimit të operatorit		Tarifat sipas vendimit të KKRR	
			lekë/klientë/muaj fikse	lek/m3 variabël	lekë/klientë/muaj fikse	lek/m3 variabël	lekë/klientë/muaj fikse	lek/m3 variabël
Sha UK Durrës	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	100	61	150	70	150	70
		Klientë publikë	100	115	150	120	150	120
		Klientë privat	100	125	150	130	150	130
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		37		50		50
		Klientë publikë		54		60		60
		Klientë privat		54		60		60
Sha UK Berat Kuçovë	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	100	44	120	48	100	48
		Klientë publikë	200	125	240	138	200	130
		Klientë privat	200	125	240	138	200	130
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		12		13		13
		Klientë publikë		20		22		22
		Klientë privat		20		22		22
Sha UK Lushnje Qytet	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	100	54	100	60	100	58
		Klientë publikë	200	125	200	130	200	130
		Klientë privat	200	135	200	150	200	140
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		15		17		17
		Klientë publikë		20		21		21
		Klientë privat		22		24		24
Sha UK Gjirokastrë Qytet	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	80	39	100	43	80	43
		Klientë publikë	80	112	200	123	80	125
		Klientë privat	80	124	200	136	80	130
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		9		10		10
		Klientë publikë		14		16		16
		Klientë privat		14		16		16

Aneksi 5. Vlera e faturës mujore (me TVSH) për klientët familjarë - viti 2017

Operatori		Fatura aktuale		Fatura e propozuar nga operatori		Fatura sipas vendimit KKRR		Të ardhurat mesatare për familje *	Pesha specifike e faturës ndaj të ardhurave mesatare(sipas vendimit/propozimit)**	
		Me matës (12m³)	Pa matës (18 m³)	Me matës (12m³)	Pa matës (18 m³)	Me matës (12m³)	Pa matës (18 m³)	lekë/muaj	Me matës (%)	Pa matës(%)
Sh.a UK Tiranë		926	1,330	1,334	1,882	926	1,330	33,569	3%	4%
Sh.a UK Korçë ekzistuese		1,570	2,282	1,810	2,630	1,810	2,630	31,289	6%	8%
Sh.a UK Korçë zonat e reja	Mollaj + Bulgarec Qender	432	648	667	941	667	941	26,557	3%	4%
	Voskop + Komuna Vithkuq + Bulgarec (të tjerat)	288	432	523	725	523	725	26,557	2%	3%
	Drenovë	216	324	523	725	523	725	26,557	2%	3%
	Voskopojë	144	216	523	725	523	725	26,557	2%	3%
Sh.a UK Berat Kuçovë ekzistuese		926	1,330	1,022	1,462	998	1,438	29,248	3%	5%
zonat e reja	Otlak Velabisht Sinje Kozare Lumas	1,047	1,511	1,042	1,502	1,042	1,502	22,323	5%	7%
	Roshnik	1,047	1,511	898	1,286	898	1,286	22,323	4%	6%
Sh.a UK Durrës		1,531	2,237	1,908	2,772	1,908	2,772	39,507	5%	7%
Sh.a UK Lushnjë		1,114	1,610	1,229	1,783	1,200	1,740	30,218	4%	6%
Sh.a UK Gjirokastrë		787	1,133	883	1,265	859	1,241	35,881	2%	3%
Sh.a UK Krujë zonat e reja	Krujë	590	886	619	929			39,507	2%	2%
	Fushë-Krujë	490	734	619	929			39,507	2%	2%
Sh.a U Gramsh		-	-	533	763			29,559	2%	3%
Sh.a UK Skrapar		389	583	768	1,092			22,323	3%	5%
Sh.a UK Fier	Frakull	1,075	1,493	1,176	1,644			30,218	4%	5%
	Topojë	1,176	1,644	1,176	1,644			30,218	4%	5%
	Qendër	1,176	1,644	1,176	1,644			30,218	4%	5%
	Cakran	720	1,080	1,176	1,644			30,218	4%	5%
	Dermenas	792	1,188	1,176	1,644			30,218	4%	5%
	Mbrostar	720	1,080	1,176	1,644			30,218	4%	5%
	Portez	648	972	1,176	1,644			30,218	4%	5%
	Levan	648	972	1,176	1,644			30,218	4%	5%
	Libofshë	576	864	1,176	1,644			30,218	4%	5%
Sh.a U Malësi e Madhe		720	1,080	720	1,000			34,957	2%	3%
Sh.a UK Shkodër		912	1,308	1,248	1,752			38,294	3%	4%
Sh.a UK Maliq ***		607	540	773	665			26,557	2%	3%

* Informacioni është marrë nga INSTAT 2014 për zonat rurale janë marrë decilet, ndërsa për urbane quintile

** Për operatorët ku ERRU ka marrë vendim llogaritjet janë bërë sipas tarifave të vendosura, ndërsa për operatorët në proces llogaritjet janë sipas propozimit të operatorit

*** Propozon tarifë fikse për ujin e ndotur 50 lekë/klient/muaj

Aneksi 6. Situata e disa treguesve të performancës për shoqëritë UK

Nr	Shoqëritë	Mbulimi i kostove O&M	Uji pa të ardhura	Norma e arkëtimit
1	Kamzë UK Sh.a	184%	46.46	82.55
2	Korçë UK Sh.a	174%	30.26	72.94
3	Tiranë UK Sh.a	174%	64.06	94.99
4	Lezhë UK Sh.a	161%	39.93	81.32
5	Ersekë UK Sh.a	158%	52.27	92.46
6	Bilisht U Sh.a	153%	10.47	87.96
7	Sarandë UK Sh.a	136%	69.08	76.2
8	Berat - Kuçovë UK Sh.a	136%	81.4	97.73
9	Pogradec UK Sh.a	126%	32.55	90.62
10	Burrel UK Sh.a	124%	40.14	79.24
11	Kukës UK Sh.a	124%	46.33	54.86
12	Librazhd UK Sh.a	119%	73.73	94.48
13	Himarë UK Sh.a	114%	34.89	77.65
14	Gramsh U Sh.a	111%	37.77	82.85
15	Elbasan (q) UK Sh.a	110%	77.74	52.63
16	Gjirokastër (Q) UK Sh.a	104%	67.12	94.53
17	Malësi e Madhe U Sh.a	104%	60.47	52.91
18	Fier UK Sh.a	101%	66.56	120.27
19	Tropojë Sh.a U	98%	58.12	46.8
20	Shkodër UK Sh.a	97%	62.02	62.51
21	Peshkopi U Sh.a	94%	30.22	61.37
22	Bulqizë U Sh.a	88%	53.21	75.78
23	Cërrik UK Sh.a	85%	59.51	87.94
24	Ura-Vajguore U Sh.a	81%	39.04	67.07
25	Pukë	79%	76.29	83.34
26	Delvinë UK Sh.a	78%	67.64	77.06
27	Durrës UK Sh.a	78%	70.87	73.63
28	Vorë UK Sh.a	77%	46.19	74.05
29	Përmet U Sh.a	76%	40.73	89.73
30	Lushnjë (Q) UK Sh.a	75%	80.54	63.09
31	Mirditë UK Sh.a	71%	52.1	70.06
32	Roskovec UK Sh.a	70%	64.97	48.38
33	Selenicë U Sh.a	68%	62.99	67.5
34	Belsh UK Sh.a	67%	28.79	71.79
35	Has U Sh.a	67%	47.15	72.03
36	Kavajë UK Sh.a	67%	42.84	69.06
37	Këlcyrë Sh.a	67%	79.69	58.84
38	Rrogozhinë UK Sh.a	66%	64.23	60.48
39	Vlorë U Sh.a	64%	78.21	61.05
40	Pustec UK Sh.a	64%	75.23	56.45
41	Elbasan (F) U Sh.a	63%	56.35	90.08
42	Fushë Arrëz UK Sh.a	62%	66.83	57.62
43	Tepelenë UK Sh.a	62%	58.88	75.2
44	Lushnjë (F) U Sh.a	61%	51.31	80.13
45	Maliq UK Sh.a	61%	33.78	98.22
46	Krujë UK Sh.a	60%	58.74	66.49
47	Polican U Sh.a	60%	59.93	74.63
48	Peqin U Sh.a	57%	44.65	65.16
49	Divjakë U Sh.a	54%	48.99	64.21
50	Kurbin U Sh.a	49%	67.66	76.47
51	Vau Dejës U Sh.a	48%	54.96	74.5
52	Libohovë UK Sh.a	46%	55.57	62.72
53	Çorovodë U Sh.a	43%	57.82	77.75
54	Konispol	41%	30.67	94.77
55	Mallakastër UK Sh.a	40%	49.3	76.67
56	Patos U Sh.a	18%	56.72	72.23

Aneksi 7. Situata e tarifave aktuale, viti 2017 për shërbimet UK

Nr	Lloji i shoqërisë	Emërtimi	2017											
			Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm						Shërbimi i largimit të ujërave të ndotur					
			Tarife variabel			Tarife fikse			Tarifa variabël			Tarifa fikse		
			Familjar	Buxhetor	Privat	Familjar	Buxhetor	Privat	Familjar	Buxhetor	Privat	Familjar	Buxhetor	Privat
1	Sh.a UK	Cerrik												
2	Sh.a UK	Belsh												
3	Sh.a UK	Berat-Kucove	50	150	150	100	200	200	14	24	24			
	Nj.Administrative	Roshnik	40	150	150	100	200	200	14	24	24			
4	Sh.a U	Bilisht (Devoll)	38	100	110	50	50	50						
5	Sh.a U	Bulqize	17	55	75	100	100	100						
6	Sh.a U	Burrel (Mat)	23	60	80				2	4	6			
7	Sh.a UK	Delvine	48	100	100									
8	Sh.a U	Divjake												
9	Sh.a UK	Durres	70	120	130	150	150	150	50	60	60			
10	Sh.a UK	Elbasan (Elber shpk)	38	115	130				8	25	30			
11	Sh.a U	Elbasan Fshat	38	120	120	120	120	120						
12	Sh.a U	Erseke	38	100	110	100	100	100	10	13	18			
13	Sh.a UK	Fier	52	105	125	200	200	200	13	18	20			
14	Sh.a UK	Fushe Arrez												
15	Sh.a UK	Fushe Kruje	28	60	80				6	10	12			
16	Sh.a UK	Gjirokaster	43	125	130	80	80	80	10	16	16			
17	Sh.a U	Gjirokaster Fshat	25	60	60									
18	Sh.a U	Gramsh	32	90	90	60	180	150						
19	Sh.a U	Has	25	60	80									
20	Sh.a UK	Himare												
21	Sh.a UK	Kavaje	38	80	100				15	20	20			
22	Sh.a U	Kelcyre												
23	Sh.a UK	Korçe	72	117	140	140	140	140	42	64	64			
	Nj.Administrative	Mollaj, Bulgarec	38	110	100	100	100	100						
	Nj.Administrative	Voskop, Komuna Vithkuq, Bulgarec (te tjera)	28	110	100	100	100	100						
	Nj.Administrative	Drenove	28	110	100	100	100	100						
	Nj.Administrative	Voskopojë	28	110	100	100	100	100						
24	Sh.a U	Kraste	30	80	100				7	10	15			
25	Sh.a UK	Kruje	33	80	80				8	12	12			
26	Sh.a UK	Kukes	25	60	80				7	15	20			
27	Sh.a U	Kurbin	30	80	120	50	50	50						
28	Sh.a UK	Lezhe	58	135	145	200	200	200	18	22	27			
29	Sh.a UK	Libohovë												
30	Sh.a UK	Librazhd	38	100	100				13	22	23			
31	Sh.a UK	Lushnje	58	130	140	100	200	200	17	21	24			
32	Sh.a U	Lushnje Fshat	60	70	100									
33	Sh.a UK	Mallakaster												
34	Sh.a U	Malsia e Madhe	50	120	120									
35	Sh.a UK	Mirdite (Rreshen)	30	100	115				10	15	15			
36	Sh.a U	Novosele	33	50	70									
37	Sh.a U	Orikum	25	70	75	100	100	100						
38	Sh.a U	Patos												
39	Sh.a UK	Peqin	30	90	100	50	50	50						
40	Sh.a U	Permet	40	110	120	100	100	200						
41	Sh.a U	Peshkopi	27	65	85				10	15	18			
42	Sh.a UK	Pogradec	22/62	37/111	37/111	200	400	400	11/33	12/36	12/36	100	100	150
43	Sh.a U	Polican	37	80	95									
44	Sh.a UK	Puke	35	130	140	100	100	100	8	16	16			
45	Sh.a UK	Puke Fshat												
46	Sh.a UK	Rrogozhinë	48	90	100	50	100	100	10	12	12			
47	Sh.a UK	Rubik	30	70	100				7	10	15			
48	Sh.a UK	Sarandë	52	138	138	150	150	150	20	31	31			
49	Sh.a U	Selenice	30	80	100									
50	Sh.a UK	Shkoder	40	110	110	100	100	100	15	20	20			
51	Sh.a U	Skrapar - Corovode	27	80	95									
52	Sh.a U	Tepelene	33	100	120	90	400	250	12	20	20			
53	Sh.a UK	Tirane	65	140	155	200	200	200	11	30	35			
54	Sh.a U	Tropojë	19	60	80									
55	Sh.a U	Ura Vajgurore	40	90	100									
56	Ndërmarrje	Vau i Dejes												
57	Sh.a U	Vlorë	30	60	80				11	13	13			
58	Sh.a UK	Vore												
59	Sh.a UK	Roskovec												

Të sigurojmë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.